



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

KOSOVO
INVESTMENT
AND ENTERPRISE
SUPPORT AGENCY **KIESA**

STUDIMI I ZONAVE EKONOMIKE NË KOSOVË



Nëntor, 2024

KONTRAKTUAR NGA:



Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

Adresa: Rr. "Arbënor e Astrit Dehari",
Lagjja e Spitalit nr. 21, 10000 Prishtinë, Republika
e Kosovës

Tel: +383 (0) 38 200 36542

E-mail: info.kiesa@rks-gov.net

IMPLEMENTUAR NGA:



D&D Business Support Center

Adresa: Rr. Xheladin Hana, Iliria Building,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Email: info@dd-bsc.com

Tel: +383 (0) 38 748 701

Web: www.dd-bsc.com

TITULLI I PROJEKTIT:

“Hartimi i studimit të Zonave Ekonomike në Kosovë”

NUMRI I PROKURIMIT:

204-23-13981-2-2-1

LISTA E SHKURTESAVE

MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
AIE	Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
FTZ	Free Trade Zone (Zonë e Tregtisë së Lirë)
HDI	Human Development Index (Indeksi i Zhvillimit Njerëzor)
IHD	Investimet e Huaja Direkte
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OSTIM	Qendra e Organizuar për Industrinë dhe Eksportin e Tregtisë
RSB	Regjistri i Shoqatave të Biznesit
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SNKA	Sistemi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
ZE	Zonat Ekonomike
ZES	Zona ekonomike Speciale
ZLT	Zonë e Lirë Tregtare
ZTE	Zona të Tregtisë Ekonomike
PIT	Parqet Industriale dhe Teknologjike

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive	7
Metodologjia	8
Kapitulli I	9
Koncepti i zonave ekonomike aktuale në Kosovë	9
1. Hyrja	9
2. Qëllimi	10
3. Përshkrimi i gjendjes aktuale të zonave ekonomike, aktivitetet biznesore, si dhe mënyra e financimit, përfshirë vlerat e investimeve publike dhe atyre private nga bizneset	11
4. Aktivitete që ushtrohen nga ana e bizneseve sipas sektorëve	16
5. Përcaktimi i zonave ekonomike aktuale në nivel botëror	20
6. Zonat ekonomike nëpër vende të ndryshme të Botës	24
7. Vlerësimi i sektorëve aktual dhe potencial të investimeve në kuadër të parqeve Industriale duke theksuar avantazhet e tyre konkurruese	27
8. Analiza dhe vlerësimi mbi fuqinë punëtore, përfshirë ndikimin në rritjen e prodhimit, punësimit sipas kualifikimit, gjinisë dhe moshës	27
9. Analiza dhe vlerësimi mbi përfitimet dhe sfidat socio-ekonomike me të cilat përballen komunitetet përreth dhe rajonit	32
10. Analiza dhe vlerësimi mbi të hyrat nga zonat ekonomike përfshirë qiratë, pagat etj	36
11. Analiza e Shitjeve	37
12. Analiza dhe vlerësimi mbi ndikimin e zonave ekonomike në rritjen e eksporteve dhe zëvendësimin e importeve	38
13. Analiza dhe vlerësimi mbi ndikimin e zonave ekonomike në nivel lokal dhe qendror ..	39
14. Pasqyrë mbi administrimin e parqeve industriale dhe teknologjike	40
15. Identifikimi i statusit dhe sipërfaqes së pronave për secilën Zonë Ekonomike	42
16. ANALIZA SWOT	45
17. Konkluzione	46
18. Rekomandime	46
Kapitulli II	48
Krijimi i Parqeve Industriale dhe Teknologjike të reja të mundshme në Kosovë	48
1. Hyrje	48
2. Qëllimi	48
3. Përshkrimi i gjendjes aktuale të shtatë regjioneve përfshirë komunat që kanë potencial për themelimin të Parqeve Industriale dhe Teknologjike	49
4. Sektorët e bizneseve më të zhvilluara në regjione	52
5. Identifikimi i mundësive për tërheqjen e investimeve të huaja dhe vendore	56
6. Identifikimi i mundësive të bashkëpunimit ndërmjet Parqeve Industriale dhe Teknologjike dhe palëve të interesit	56
7. Identifikimi i fuqisë punëtore sipas regjioneve	58

5.	Hulumtimi nga takimet me përfaqësuesit e komunave.....	63
8.	Hulumtimi nga intervistat e realizuara me biznese potenciale për tu vendosur në parqet Industriale dhe Teknologjike	65
9.	Identifikimi i rreziqeve të mundshme mjedisore	69
10.	Të identifikohet dhe të vlerësohet karakteristikat miqësore	70
11.	ANALIZA SWOT	72
12.	Konkluzione.....	73
13.	Rekomandime	73
	Kapitulli III	74
	Legjislacioni i zonave ekonomike në Kosovë	74
1.	Analizimi i legjislacionit të parqeve industriale dhe teknologjike vendore dhe ndërkombëtare.....	74
2.	Krahasim i legjislacionit të zonave ekonomike midis Kosovës dhe Shqipërisë.....	75
3.	Krahasim i Legjislacionit të Zonave Ekonomike midis Kosovës dhe Italisë	77
4.	Krahasim i legjislacionit të zonave ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë.....	79
5.	Legjislacioni i zonave ekonomike në Maqedoninë e Veriut.....	80
6.	Palët kryesore të interesit	82
7.	Konkluzione.....	83
8.	Rekomandime	83
9.	Aneks 1. Vendimet e themelimit të zonave ekonomike	84

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Vlera e përafërt e investimit nga ana e bizneseve	17
Figura 2. Burimet e financimit nga ana e bizneseve	18
Figura 3. Përfaqësimi gjinor i fuqisë punëtore.....	31
Figura 4. Ndikimi i zonave ekonomike në rritjen e eksporteve dhe zëvendësimin e importeve	39
Figura 5. Lloji i pronës.....	57
Figura 6. Sektorët e bizneseve më të përshtatshme për tu vendosur në parqet Industriale ose Teknologjike	61
Figura 7. Mbështetja financiare për bizneset	62
Figura 8. Potenciali i komunave për krijimin e Parqeve Industriale dhe Teknologjike	63
Figura 9. Toka e disponueshme	64
Figura 10. Ndikimi i krijimit të parkut industrial tek bizneset	65
Figura 11. Sektori i bizneseve potenciale për tu vendosur në Parqet Industriale dhe Teknologjike	66

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Veprimtaritë nga ana e bizneseve në Zonat Ekonomike.....	16
Tabela 2. Burimet e financimit nga ana e bizneseve	17
Tabela 3. Treguesit e përzgjedhur për Zonat Ekonomike në Kosovë.....	19
Tabela 4. Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët.....	28
Tabela 5. Numri i nxënësve në shkolla profesionale dhe gjimnaze.....	29
Tabela 6. Fusha e Studimit.....	30
Tabela 7. Përfaqësimi gjinor	31
Tabela 8. Mosha e fuqisë punëtore	31
Tabela 9. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas muajve dhe seksioneve të aktiviteteve ekonomike.....	35
Tabela 10. Numri i NVM-ve të regjistruara gjatë vitit 2023	36
Tabela 11. Niveli i pagës mesatare bruto dhe euro, sipas viteve 2012 - 2022.....	37
Tabela 12. Ndikimi i zonave ekonomike në shitjen e produkteve.....	38
Tabela 13. Ndikimi i zonave ekonomike në rritjen e eksporteve dhe zëvendësimin e importeve	39
Tabela 14. Analiza SWOT për Zonat Ekonomike	45
Tabela 15. Ndërmarrjet e regjistruara sipas Kodi/Seksionet e aktiviteteve ekonomike, komuna, viti dhe periudha	52
Tabela 16. Përfitimet për zhvillimin e komunës apo regjionit.....	56
Tabela 17. Klasifikimi I tregut të punës për popullsinë e Kosovës, 2023	58
Tabela 18. Fuqia punëtore dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë dhe grupmoshës	58
Tabela 19. Identifikimi i fuqisë punëtore sipas regjioneve.....	59
Tabela 20. Infrastruktura aktuale	60
Tabela 21. Vlerat e përafërta për ndërtimin e parqeve.....	60
Tabela 22. Strategjitë për tërheqjen e investimeve	62
Tabela 23. Sektori i bizneseve	66
Tabela 24. Kërkesat për sipërfaqen e tokës	67
Tabela 25. Vendet e punës të cilat do të krijohen	68
Tabela 26. Analiza SWOT për komunat potenciale për krijimin e Parqeve Industriale dhe Teknologjike	72

Përmbledhje ekzekutive

Hartimi i studimit të Zonave Ekonomike në Kosovë ofron një analizë të thelluar mbi zhvillimin dhe funksionimin e zonave ekonomike në Kosovë, me fokus të veçantë në impaktin e tyre socio-ekonomik dhe sfidat që hasen në këtë proces. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përmes agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), ka krijuar disa zona ekonomike që synojnë të nxisin investimet, të krijojnë vende të reja pune dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Ky studim është hartuar nga D&D Business Support Center e kontraktuar nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA). Studimi është i ndarë në tre kapituj kryesorë:

- **Kapitulli 1** trajton përshkrimin e gjendjes aktuale të zonave ekonomike, aktivitetet biznesore dhe mënyrat e financimit të tyre. Ky kapitull ofron një analizë të detajuar të zonave ekzistuese dhe performancën e tyre deri më tani.
- **Kapitulli 2** përfshin një analizë dhe vlerësim mbi përfitimet dhe sfidat socio-ekonomike të zonave ekonomike, me fokus të veçantë në identifikimin e komunave që kanë potencial për themelimin e parqeve industriale dhe teknologjike. Ky kapitull përfshin gjithashtu një analizë të bizneseve potenciale që mund të përfitojnë nga këto zona, si dhe ndikimin ekonomik të tyre në nivel lokal dhe qendror.
- **Kapitulli 3** përqendrohet në krahasimin e legjislacionit të zonave ekonomike midis Kosovës dhe vendeve të tjera, si Shqipëria, Italia, Sllovenia dhe Maqedonia e Veriut, dhe përshkruan kriteret për krijimin e një zone ekonomike të suksesshme.

Në Kosovë, janë krijuar 12 zona ekonomike, të cilat kanë sjellë përfitime të konsiderueshme në rritjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Disa nga zonat më të suksesshme përfshijnë Parkun e Biznesit në Drenas, Parkun e Biznesit në Mitrovicë, Parkun Teknologjik në Shtime dhe Parkun Industrial në Suharekë. Investimet publike dhe private në infrastrukturën e këtyre zonave kanë qenë të konsiderueshme, duke përfshirë rrugë, energji, ujë dhe shërbime të tjera mbështetëse.

Analiza e SWOT-it tregon se zonat ekonomike në Kosovë kanë potencial të madh për tërheqjen e investimeve të reja dhe rritjen e konkurrencës së biznesit vendor. Megjithatë, ka nevojë për përmirësimin e infrastrukturës dhe për tërheqjen e investitorëve të huaj duke promovuar dhe duke ofruar lehtësira në dhënien e pronës për shfrytëzim.

Raporti përfundon me konkluzione dhe rekomandime të rëndësishme për përmirësimin e funksionimit të zonave ekonomike në Kosovë dhe për të maksimizuar përfitimet e tyre socio-ekonomike. Këto rekomandime përfshijnë zhvillimin e infrastrukturës së avancuar, promovimin e investimeve, mbështetjen për bizneset lokale dhe krijimin e politikave më të favorshme për investitorët e huaj.

Metodologjia

Për të realizuar një analizë të detajuar mbi zonat ekonomike në Kosovë, është ndjekur një qasje metodologjike e strukturuar që përfshin mbledhjen e të dhënave primare dhe sekondare. Ky studim ka për qëllim vlerësimin e gjendjes aktuale dhe potencialit të zhvillimit të zonave ekonomike në Kosovë.

Të dhënat primare janë mbledhur përmes vizitave në terren në zonat ekonomike ekzistuese dhe ato potenciale, duke realizuar intervista me aktorët kryesorë, si menaxherët e zonave, përfaqësuesit e bizneseve, zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT). Për të arritur këtë, janë krijuar katër pyetësorë specifikë:

1. **Pyetësori i parë:** Synoi të grumbullojë informacione për komunat që kanë zonë ekonomike.
2. **Pyetësori i dytë:** Përfshinte pyetje për bizneset e vendosura brenda zonave ekonomike.
3. **Pyetësori i tretë:** Mblodhi të dhëna për komunat me potencial për krijimin e parqeve industriale dhe teknologjike të reja në Kosovë.
4. **Pyetësori i katërt:** U përqendrua në interesimin dhe informatat e bizneseve potenciale që mund të vendosen në parqet industriale dhe teknologjike.

Të dhënat sekondare përfshijnë analiza të dokumenteve strategjike, raporteve dhe legjislacionit përkatës. Të dhënat e nevojshme u mblodhën gjithashtu nga institucione relevante si Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Komunitet i Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës. Këto informacione u përdorën si plotësim dhe analizë dytësore për hartimin e studimit të Zonave Ekonomike në Kosovë, si dhe për të krahasuar praktikën më të mira ndërkombëtare nga vende si Shqipëria, Italia, Sllovenia dhe Maqedonia e Veriut.

Analiza SWOT u përdor për të identifikuar pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet për secilën zonë. Vlerësimi ekonomik u përqendrua në ndikimin e këtyre zonave në krijimin e vendeve të punës, investimeve, të ardhura nga qiratë dhe tatimet, si dhe kontributin në eksporte dhe zëvendësimin e importeve. U realizua gjithashtu një analizë ligjore për të vlerësuar përputhshmërinë e kuadrit ligjor të Kosovës me standardet ndërkombëtare.

Gjithashtu, u bë një vlerësim i infrastrukturës ekzistuese dhe u identifikuan sektorët me potencial të lartë për tërheqjen e investimeve, vendore dhe të huaja. Raporti përfundimtar përfshin rekomandime konkrete për përmirësimin e menaxhimit dhe zhvillimit të zonave ekonomike, nxitjen e politikave investuese dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Kapitulli I

Koncepti i zonave ekonomike aktuale në Kosovë

1. Hyrja

Në epokën e globalizimit, vendet e zhvilluara dhe shumica e vendeve në zhvillim janë dëshmitarë të ndryshimeve ekonomike. Një ndër format e reja të zhvillimit ekonomik është edhe ofrimi i hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve afariste biznesore, në mënyrë më të mirë të promovimit dhe zhvillimit bizneseve vendore dhe të huaja. Hapësira të tilla pune në ekonomi i përkufizojmë me termin si “zona ekonomike” apo “parqe industriale”.

Zona e parë moderne ekonomike është themeluar në Irlandë në vitin 1959, që nga ajo periudhë kohore e deri më tani, janë krijuar shumëllojshmëri të strukturave të ndryshme të zonave ekonomike, ku kanë evoluar në llojllojshmëri.

Fillimisht termi zonat ekonomike përfshinte një shumëllojshmëri të gjerë të koncepteve të përafërta, sic janë zona të lira tregtare, portet e lira, zonat e tregtisë së jashtme, zonat e përpunimit të eksportit, zonat e veçanta ekonomike, zonat e lira të eksportit, tregtisë dhe përpunimit, etj.

Përkundër variacioneve të shumta në emër dhe formë, të gjitha mund të jenë të definuar në termin e përgjithshëm si zonat e demarkuara gjeografike të përfshira brenda kufijve të caktuar, ku rregullat e biznesit janë të ndryshme nga ato që mbizotërojnë në territorin jashtë zonave ekonomike. Këto rregulla diferenciale kryesisht merren me kushtet për investime, tregti ndërkombëtare dhe dogana, tatime dhe mjedis rregullator.

Pra, ekziston një shtrirje e gjerë pajtimi me hapësira dhe objekte të përshtatshme fizike (vende apo ndërtesa me infrastrukturë të qëndrueshme) në një ambient të kontrolluar dhe menaxhuar mirë, në një lokacion të përshtatshëm, i cili është një element shumë i rëndësishëm në çdo program për zhvillimin e sektorit privat. Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik, si dhe krijimi i vendeve të reja të punës në shumicën e vendeve të botës e po ashtu edhe në Kosovë varet nga zhvillimi sektori privat.

Sfidat e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë të shumta dhe për përballimin më të suksesshëm të tyre nevojitet një mbështetje e bizneseve si në nivelin lokal ashtu edhe në nivel qendror me qëllim të krijimit të një ambienti më të përshtatshëm për zhvillimin e NVM-ve.

Nga ana tjetër kemi edhe numër të madh të bizneseve që mbyllën dhe kjo është ajo çka ne duhet të përqendrohemi në faktorët kyç që ndikojnë deri në mbylljen apo pasivizimin e këtyre bizneseve. Andaj NVM-të kanë nevojë për mbështetje, ku rol kyç dhe shumë i rëndësishëm është edhe zhvillimi i zonave ekonomike, apo të emëruar me legjislacion në Kosovë si parqe industriale dhe teknologjike. Përvojat në shumë vende të Botës vejnë në pah se zonat ekonomike janë treguar të suksesshme në krijimin, rritjen, zhvillimin, ndërlidhshmërinë dhe qëndrueshmërinë e bizneseve.

Çfarë mund të mësohet nga këto përvoja, cilat janë përvojat e funksionimit të deritanishëm të zonave ekonomike në Kosovë dhe çfarë duhet të ndërmerret në të ardhmen janë në fokus të studimit që do të trajtohet. Performanca ekonomike dhe ndikimi i programeve të zonave ekonomike në vendet në zhvillim është vlerësuar në studime të shumta. Shumica e këtyre, megjithatë, janë përqendruar në zona që janë të zhvilluara dhe të drejtuara nga qeveria, qoftë të nivelit qendror apo lokal.

2. Qëllimi

Themelimi i zonave ekonomike është i dedikuar ndaj një ekonomie të lirë, sepse në rastet kur një ekonomi e vendit në nivel nacional është shumë e mbrojtur, ajo limiton mundësitë për tregti me vendet e huaja dhe në të njëjtën kohë zvogëlon mundësitë në llojshmerinë e produkteve/shërbimeve dhe në çmimet e tyre të pavolitshme për tregun. Duke qenë të fokusuar në një tregti të lirë me vendet në rajon dhe më gjerë, vendi ynë është i dedikuar për të ofruar një hapësirë të favorshme për investimet e huaja dhe në të njëjtën kohë në zhvillimin e ekonomisë së vendit. Parku industrial themelohet për këto qëllime:

- Mbështetja e investimeve të përgjegjshme dhe të qëndrueshme;
- Nxitja e veprimtarisë prodhuese dhe përpunuese, inovacionit dhe ofrimit të shërbimit me vlerë të shtuar;
- Punësimi dhe aftësimi;
- Nxitja dhe zhvillimi i ekosistemit inovativ dhe bashkëpunimit mes shoqërive tregtare e promovimi i tyre;
- Rritja e konkurrueshmërisë dhe mbështetja e eksportit;
- Nxitja e teknologjisë së përparuar;
- Zhvillimi rajonal;
- Mbështetja e projekteve me interes të veçantë strategjik.

Qëllim tjetër i mundshëm është rritja e investimeve të sektorit privat, bashkëpunimi me bizneset ndërmjet veti, krijimin e ekosistemeve, inovacionit, rritjen e prodhimit dhe punësimit.

3. Përshkrimi i gjendjes aktuale të zonave ekonomike, aktivitetet biznesore, si dhe mënyra e financimit, përfshirë vlerat e investimeve publike dhe atyre private nga bizneset

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është institucioni përgjegjës për themelimin e zonave ekonomike, përmes së cilës janë krijuar 12 deri me tani:

1. PARKU I BIZNESIT NË DRENAS,
2. PARKU I BIZNESIT NË MITROVICË,
3. PARKU TEKNOLOGJIK NË SHTIME,
4. PARKU INDUSTRIAL NË FRASHËR – MITROVICË,
5. AGRO ZONA INDUSTRIALE NË SUHAREKË,
6. PARKU INDUSTRIAL NË SHIROKË – SUHAREKË,
7. PARKU INDUSTRIAL NË LIPJAN,
8. PARKU INDUSTRIAL NË VITI,
9. PARKU INDUSTRIAL NË VUSHTRRI,
10. PARKU INDUSTRIAL NË RAHOVEC,
11. PARKU I PËRGJITHSHËM NË PODUJEVË,
12. PARKU I PËRGJITHSHËM NË DRENAS 2.

Nga gjithsej 12 zona ekonomike të krijuara, në funksion të plotë janë: Parku i Biznesit në Drenas, Parku i Biznesit në Mitrovicë, Parku Teknologjik në Shtime dhe Parku Industrial në Suharekë, derisa të finalizuara me infrastrukturë dhe të gatshme për funksion janë: Parku Industrial në Viti, Parku Industrial në Vushtrri, ndërsa në fazën e investimit janë: Parku Industrial në Rahovec, Parku Industrial në Lipjan, Parku i Përgjithshëm në Podujevë dhe Parku Industrial në Frashër – Mitrovicë, derisa Parku i përgjithshëm në Drenas 2 është në fazën e procedurave për fillimin e ndërtimit të infrastrukturës. Në pjesën e mëposhtme të këtij studimi janë paraqitur të dhëna për secilën nga këto zona ekonomike.

PARKU I BIZNESIT NË DRENAS

Parku i biznesit në Drenas është krijuar në vitin 2010 me sipërfaqe 24 ha. Kanë përfunduar ndërtimet e infrastrukturës fizike (rrugë, rrymë, ujë, kanalizim, sigurim fizik, gjelbërim, etj). MINT ka bërë investimet në këtë park. Mënyrësisht janë të vendosura 40 biznese me veprimtari të ndryshme biznesore, të cilat biznese punësojnë mbi 782 persona.

Aktivitetet që ushtrohen nga ana e bizneseve në këtë park biznesi janë: prodhimet farmaceutike, prodhimin e lifteve, metalpunues, sektori i drurit, paneleve të ndryshëm e deri tek riciklimi i plastikes.

Bizneset që operojnë në PBD, paguajnë qira në vlerë 0.15 euro/cent për m². Mirëpo në 10 vitet e para të operimit qiraja është e përshkallëzuar.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,89> & <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/8E2AE57B-1DC7-4466-9DFC-35541BDD6704.pdf>

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike janë kryesisht publike, ku në bazë të komunës investim publik se bashku më Ministrinë është rreth 10 milion euro përfshirë edhe infrastrukturën përcjellëse, linjën e ujit dhe të rrymës, derisa investimet private të përafërta janë rreth 50 milion euro.

PARKU I BIZNESIT NË MITROVICË

Është krijuar në vitin 2012 me sipërfaqe 3.5 ha. Momentalisht është i plotësuar me 22 biznese me rreth 300 punëtorë.

Aktivitetet që ushtrohen nga ana e bizneseve në këtë park biznesi janë: riciklimi i plastikës, zdrukthëtaria, prodhimin e thasëve të letrës, tekstilit, prodhime metalike etj. Bizneset në këtë park janë të liruar nga pagesa e qirasë.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,90> & <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/2B50B634-CF68-4C2B-B8C9-6659B9837AB6.pdf>

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike janë kryesisht publike, ku në bazë të komunës investim publik se bashku më Ministrinë është rreth 200 mijë euro, derisa investimet private të përafërta janë rreth 17 milion euro.

PARKU TEKNOLOGJIK-SHTIME

Është krijuar në vitin 2013 me sipërfaqe 10.70 ha. Deri me tani të kontraktuara për t'u vendosur në Parkun Teknologjik janë 13 biznese, me rreth 250 punëtorë.

Aktivitetet që ushtrohen nga ana e bizneseve në këtë park biznesi janë: përpunimi dhe konservim i pemëve dhe perimeve, prodhime të produkteve ndërtimore, pllakave nga mermeri, përpunime të llojeve të xhamave, etj. Vlera e qirasë që paguajnë bizneset është 10 € në vit për ari.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,91> & <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/753667A3-B814-4A91-9D2C-8989FDBA13FA.pdf>

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike janë kryesisht publike, ku në bazë të komunës investim publik se bashku më Ministrinë është rreth një milion euro, derisa investimet private të përafërta janë rreth 10 milion euro.

PARKU INDUSTRIAL NË FRASHËR – MITROVICË

Është krijuar në vitin 2014 me sipërfaqe 48 ha, si dhe kanë filluar punimet në nivelimin e terrenit. Tani janë riaktivizuar mbështetjet financiare nga Ministria për ta ndërtuar dhe zhvilluar këtë park industrial dhe për të qenë i gatshëm për biznese.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,92> & <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/245369B3-BF97-469A-9EFB-C46537BE0CE7.pdf>

Është duke zhvilluar aktivitetet biznesor vetëm dy biznese me aktivitetet në fushën e produkteve të ndërtimit.

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike janë kryesisht publike, ku në bazë të komunës investim publik se bashku me Ministrinë është rreth 500 mijë euro dhe tani më një kontratë edhe për 1.1 milion euro investim derisa investimet private të përafërta janë rreth 1 milion euro, duke pasur parasysh se zona është ende e papërfunduar dhe janë në fillimin e vendosjes ku deri tani janë 2 biznese aktive dhe të punësuar rreth 10 persona.

ZONA AGRO – INDUSTRIALE NË SUHAREKË

Është krijuar në vitin 2015 me sipërfaqe prej 28 ha, si dhe kanë filluar punimet në nivelimin e terrenit, mirëpo në mungesë të mjeteve buxhetore ende nuk është arritur në ndërtimin e infrastrukturës fizike për të u vendosur bizneset.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,93> & <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/B818C558-FC0A-4247-866C-BE1796633C63.pdf> Këtu nuk ka aktivitetet biznesor.

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike janë kryesisht publike, ku në bazë të komunës investim publik se bashku me Ministrinë është rreth 300 mijë euro, ndërsa investimet private të përafërta janë rreth 50 mijë euro.

PARKU INDUSTRIAL NË KOMUNËN E LIPJANIT

Është krijuar në vitin 2016 me sipërfaqe 56 ha. Ku kanë filluar investimet në këtë zonë ekonomike dhe janë duke vazhduar në rregullimin e infrastrukturës fizike, si në rrugë, rrymë dhe ujë. Gjatë vitit 2022 komuna e Lipjanit ka shpallur konkursin për vendosje të bizneseve të para në këtë park industrial. Ende nuk zhvillohet ndonjë aktivitet biznesor.

Sa i përket kushteve të qirasë, komuna ofron një periudhë 3-vjeçare pa pagesë, pas së cilës qiraja varion nga 0.07 euro për metër katror për periudhën 4 deri në 7 vite, 0.11 euro për metër katror për periudhën 8 deri në 10 vite dhe 0.125 euro për metër katror për periudhën mbi 11 vite.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,94> & <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/A7AD7B4A-841E-4172-8DA3-E8C7BBAF831B.pdf>

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike janë kryesisht publike, ku në bazë të komunës investim publik se bashku më Ministrinë është rreth 1.5 milion euro dhe është në fazë të investimit, derisa investimet private nuk ka.

PARKU INDUSTRIAL NË VITI

Është krijuar në vitin 2017 me sipërfaqe prej 15.50 ha. Me investim të MINT kanë përfunduar investimet infrastrukturore dhe është e gatshme për dhënie të bizneseve në shfrytëzim. Komuna ka shpallur thirrjen për biznese dhe planifikon të vendos deri në 40 biznese.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,96> & <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/57D6D976-34A5-4E0D-BA3D-1509510B405E.pdf>

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike janë kryesisht publike, ku në bazë të komunës investim publik se bashku më Ministrinë është rreth 1.7 milion euro, derisa investimet private nuk ka, por janë në fazën e vendosjes se bizneseve.

PARKU INDUSTRIAL NË SHIROKË – SUHAREKË

Është krijuar në vitin 2017 me sipërfaqe prej 162 ha, sipas Komunës janë të vendosura 56 biznese aktive dhe 1668 punëtorë.

Aktivitetet që ushtrohen nga ana e bizneseve në këtë park biznesi janë: prodhimin e këpucëve, fasadave, përpunues i pijeve freskuese, prodhimin e elementeve nga betoni, përpunim dhe konservim të perimeve, përpunimin e mermerit dhe granitit etj.

Vlera e qirasë që paguajnë bizneset në kuadër të Parkut Industrial në Shirokë është 500 € në vit për hektarë.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,95> & <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/7A773E89-5E44-4C7C-9D41-157737E8C7D5.pdf>

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike janë kryesisht publike, ku në bazë të komunës investim publik se bashku më Ministrinë është rreth 3 milion euro, derisa investimet private të përafërta janë rreth 70 milion euro.

PARKU INDUSTRIAL NË VUSHTRRI

Është krijuar në vitin 2018, me sipërfaqe prej 14.86 ha. Me investim të MINT kanë përfunduar investimet infrastrukturore dhe është e gatshme për dhënie të bizneseve në shfrytëzim. Komuna ka shpallur thirrjen për biznese dhe planifikon të vendos deri në 23 biznese.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,178> & <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/E0FE95E6-25AB-4E55-8494-09EA7A52DB40.pdf>

Ende nuk zhvillohet ndonjë aktivitet biznesor.

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike janë kryesisht publike, ku në bazë të komunës investim publik se bashku me Ministrinë është rreth 1.4 milion euro, derisa investimet private nuk ka, por janë në fazën e vendosjes se bizneseve.

PARKU INDUSTRIAL NË RAHOVEC

Është krijuar në vitin 2020, me sipërfaqe prej 34.89 ha. Me investim të MINT janë në përfundim të fazës së parë të investimit dhe duke planifikuar të fillojnë fazën e dytë dhe të fundit për lëshim në funksion. Planifikohet se gjatë vitit të ardhshëm të fillojë vendosja e bizneseve.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,179> & <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/49878E8D-3100-4AAE-A6D0-484E6FD822BE.pdf>

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike janë kryesisht publike, ku në bazë të komunës investim publik se bashku me Ministrinë është rreth 1.5 milion euro dhe rreth 1 milion në proces, derisa investimet private ende nuk ka, pasi që nuk ka përfunduar infrastruktura.

PARKU I PËRGJITHSHËM NË PODUJEVË

Është krijuar në vitin 2024, me sipërfaqe prej 29,80 hektar. Me investim të MINT planifikohet të përfundojë deri në vitin 2026 dhe të jetë e gatshme për lëshim në funksion. Planifikohet që të vendosen rreth 50 biznese.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/F4318FBE-B9CF-46EA-B332-FC340E61BF7C.pdf>

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike janë kryesisht publike, ku në bazë të komunës investim publik se bashku me Ministrinë është planifikuar të jetë rreth 3.8 milion euro brenda tri viteve, derisa investimet private ende nuk ka, pasi që nuk ka përfunduar infrastruktura.

PARKU I PËRGJITHSHËM NË DRENAS

Parku i përgjithshëm në Drenas 2, i krijuar në vitin 2024, ka një sipërfaqe prej 36,50 hektarë. Projekti është në fazën e procedurave për fillimin e ndërtimit të infrastrukturës, e cila parashikohet të përfundojë brenda tre viteve.

Linqet mbështetëse: <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/7BC1511D-2A42-48DF-8AFE-0C4062877B19.pdf>

Mënyra e financimit

Vlen të theksohet se investimet në infrastrukturë bazike fizike do të jene publike, ku në bazë të komunës dhe Ministrisë është planifikuar të jenë rreth 9 milion euro brenda tri viteve, derisa investimet private ende nuk ka, pasi që nuk ka përfunduar infrastruktura.

4. Aktivitete që ushtrohen nga ana e bizneseve sipas sektorëve

Gjatë këtij studimi, nga 132 bizneset e vendosura në zonat ekonomike, prej tyre kemi intervistuar 120 biznese. Ky sondazh synonte të mbledhë informacione të detajuara rreth veprimtarive të tyre, sfidave me të cilat përballen dhe mundësive për zhvillim të mëtejshëm. Të dhënat e mbledhura na lejojnë të krijojmë një pasqyrë të qartë mbi gjendjen aktuale të zonave ekonomike dhe të ofrojmë rekomandime për përmirësimin e tyre. Përmes kësaj analize, synojmë të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të suksesshëm të industrisë në vend.


Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e veprimtarive në katër kategori kryesore: prodhuese dhe përpunuese, tregtare, dhe shërbyese. Nga totali prej 120 bizneseve të intervistuar, 80.83% i përkasin veprimtarisë prodhuese dhe përpunuese, që përfaqëson pjesën më të madhe të aktiviteteve. Veprimtaritë tregtare përfaqësojnë rreth 10% të aktiviteteve, ndërsa veprimtaritë shërbyese përbëjnë 9.17% të totalit.

Tabela 1. Veprimtaritë nga ana e bizneseve në Zonat Ekonomike

Veprimtaria	Bizneset e anketuara	Përqindja
Prodhuese dhe Përpunuese	97	80.83%
Tregtare	12	10%
Shërbyese	11	9.17%
Total	120	100%

Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Figura 1. Vlera e përafërt e investimit nga ana e bizneseve



Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve


Figura e mësipërme paraqet shpërndarjen e vlerës së përafërt të investimit nga ana e bizneseve në disa kategori. Nga totali prej 120 bizneseve të intervistuar, 46.67% kanë investuar deri në 500 mijë euro, që përfaqëson grupin më të madh. Ndërkohë, 32.50% e bizneseve kanë investuar nga 1 milion deri në 3 milion euro, duke e bërë këtë grupin e dytë më të madh. Bizneset që kanë investuar nga 501 mijë euro deri në 1 milion euro përbëjnë 13.33% të totalit. Grupet e tjera përfshijnë 5.83% të bizneseve që kanë investuar nga 3 milion deri në 5 milion euro, dhe vetëm 0.83% të bizneseve kanë investuar nga 5 deri në 10 milion euro, si dhe mbi 10 milion euro kemi 0.83%. Kjo tregon një përqendrim të lartë të bizneseve me investime më të ulëta, me një numër të vogël biznesesh që kanë bërë investime të mëdha.

Tabela 2. Burimet e financimit nga ana e bizneseve

Burimet e financimit në ndërtim të objekteve biznesore nga ana e bizneseve?	Numri i përgjigjeve të bizneseve	Përqindja
Bashkëfinancim	15	6.94%
Kredi	82	37.96%
Mjete vetanake	111	51.39%
Donator	8	3.70%
Total	216	100%

Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Figura 2. Burimet e financimit nga ana e bizneseve



Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Figura 2 paraqet burimet e financimit të përdorura nga bizneset për ndërtimin e objekteve biznesore. Nga totali prej 216 përgjigjeve, në disa raste ka pasur përgjigje të dyfishta, pra një biznes ka dhënë dy e më shumë përgjigje, andaj i bie se shumica e bizneseve kanë raportuar se kanë përdorur mjete vetanake, që përfaqëson 51.39% të përgjigjeve. Kreditë janë përdorur nga 37.96% e bizneseve, duke treguar një varësi të konsiderueshme nga financimi përmes huamarrjes. Bashkëfinancimi është zgjedhur nga 6.94% e bizneseve, ndërsa donatorët kanë kontribuar në 3.70% të rasteve. Meqenëse një biznes mund të zgjedhë më shumë se një opsion, këto përqindje reflektojnë kombinimet e ndryshme të burimeve të financimit që bizneset kanë përdorur për të mbuluar kostot e ndërtimit.

Në bazë të hulumtimeve, vërehet se madhësia e zonave ekonomike ndryshon në mënyrë të konsiderueshme duke filluar nga ajo më e vogla me madhësi prej 3.5 ha në Parkun e Biznesit të Mitrovicës deri të ajo më e madhja me sipërfaqe 162 ha në Parkun Industrial në Shirokë të Suharekës. Performanca e zonave ekonomike në Kosovë në drejtim të tërheqjes së investitorëve dhe krijimit të vendeve të punës ka qenë e moderuar deri më tani. Zonat që janë tashmë funksionale kanë rreth 132 biznese me 3063 punonjës të deklaruar nga bizneset. Sipas intervistave të kryera si pjesë e vizitave në terren në gusht të vitit 2024, investitorët e huaj luajnë një rol të vogël, kjo ka mundur të jetë si rrjedhojë e promovimit të vogël të zonave ekonomike. Për shembull, në Parkun e Biznesit të Drenasit, vetëm 6 nga 40 kompani janë të përfshirë investitorë të huaj. Në Parkun industrial në Shirokë Suharekë kemi vetëm 2 nga 56 kompanitë që janë të përfshirë investitorë të huaj, dhe në Parkun Teknologjik në Shtime kemi vetëm 1 nga 11 biznese që janë të përfshirë investitor të huaj. Shumica e kompanive në zona ekonomike janë NVM lokale.

Tabela 3. Treguesit e përzgjedhur për Zonat Ekonomike në Kosovë

Zona ekonomike	Viti i themelimit	Madhësia (ha)	Infrastruktura	Kompanitë aktive	Punonjësit	Investimet Publike	Investimet Private
Parku i biznesit Drenas	2010	24	Finalizuar	40	782	10,000,000	50,000,000
Parku i biznesit Mitrovicë	2012	3.5	Finalizuar	22	397	200,000	17,000,000
Parku teknologjik Shtime	2013	10.7	Finalizuar	11	206	1,000,000	10,000,000
Parku Industrial në Frashër- Mitrovicë	2014	48	Faza e hershme – në fazë të investimit	3	10	500,000	1,000,000
Zona Agro Industriale Suharekë	2015	28	Faza e hershme	-	-	300,000	-
Parku Industrial Lipjan	2016	56	Pjesërisht e zhvilluar – në fazë të investimit	-	-	1,500,000	-
Parku Industrial Shiroke Suharekë	2017	162	Finalizuar	56	1668	3,000,000	70,000,000
Parku Industrial Viti	2017	15.5	Finalizuar – në proces për vendosje të bizneseve	-	-	1,700,000	-
Parku Industrial Vushtri	2018	14.8	Finalizuar – në proces për vendosje të bizneseve	-	-	1,400,000	-
Parku Industrial Rahovec	2020	35	Pjesërisht e zhvilluar – në fazë të investimit	-	-	1,500,000	-
Parku i Përgjithshëm në Podujevë	2024	30	Në fazën fillestare të investimit	-	-	3,800,000	-
Parku i Përgjithshëm në Drenas	2024	36.50	Në fazën fillestare të investimit	-	-	9,000,000	-

Burimi: KIESA, intervistat me komunat

5. Përcaktimi i zonave ekonomike aktuale në nivel botëror

Format e zonave ekonomike janë rezultat i disa faktorëve, duke përfshirë:

- (1) Nevoja për të bërë dallimin ndërmjet llojeve të zonave që shfaqin dallime të vërteta në formë dhe funksion,
- (2) Dallimet në terminologjinë ekonomike ndërmjet vendeve,
- (3) Dëshira për të diferencuar produktin e tyre nga ato të konkurrencës.

Përkufizimet e zonave ekonomike ndryshojnë në të gjithë vendet dhe evoluojnë vazhdimisht drejt zhvillimit ekonomik bashkëkohor. Çdo përpjekje për zhvillim të zonave ekonomike duhet të jetë mjaft i gjerë për të përfshirë zonat në të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen.

Në literaturë gjejmë koncepte të ndryshme të përkufizimeve të zonave ekonomike me terme të ndryshme por që kanë kuptimin e zonës ekonomike. Varësisht nga përcaktimi politik i një vendi gjejmë variacione të përdorimit të terminologjisë së tyre për të përshkruar llojin e zonës.

Pavarësisht dallimet në nomenklaturë, secila prej tyre vepron për të rritur tregtinë në mbarë rajonin e saj përkatës, duke ofruar lehtësira të veçanta të tregtisë për të stimuluar investimet të huaja, në rajon dhe vend. Andaj për me gjerësisht do të shqyrtojmë disa nga tipet apo llojet e zonave ekonomike nga ato më të njohurat që funksionojnë nëpër botë.

Zonat e posaçme ekonomike

Janë klasifikuar në përgjithësi si zona që nxisin rritjen e tregtisë, të strukturuar përmes skemave tatimore të dobishme dhe të reduktuara nga mbikëqyrja doganore. Shumë nuanca kanë zhvilluar brenda kësaj kornize të gjerë për të akomoduar industri të specializuara, kushte të punës, infrastrukture të vendit, mbikëqyrje të qeverisë, etj.

Zona e Tregtisë së Lirë

Një nga llojet më të shtrira të zonave ekonomike speciale, janë ato të Tregtisë së Lirë (FTZ) . Një FTZ është një teritor zakonisht gjeografikisht i rrethuar, taksa të rregulluara ndryshe nga të zakonshmet, mundësi magazinimi, shpërndarje, tregti dhe import/eksport, operacionet në një mjedis rregullator të reduktuar, që do të thotë se ata përgjithësisht kanë kontrollë më të rreptë të punës doganore, mirëpo më përfitime (lehtësira). Këto zona përgjithësisht përqendrohen në operacionet e prekshme të tregtisë ndërkombëtare.

Zonat e Trajtimit të Eksportit (Zone Processing Export)

Këto zona janë pasuri industriale të dedikuara kryesisht tregjeve të huaja, ku prodhuesit e huaj gëzojnë privilegjin e importit të gjysmë fabrikantëve, taksave, përdorimit të infrastrukturës dhe përjashtimin nga rregullat dhe ligjet e ndryshme që zbatohen në pjesën tjetër të vendit. Zonat janë veçanërisht tërheqëse për punët intensive në industri të tilla si: veshje dhe këpucë, montimin e komponentëve elektronik etj, dhe kështu kërkojnë një fuqi punëtore me aftësi të ZTE-të. Janë hibride dhe kanë zakonisht nën-ndarje në zonë të përgjithshme të hapur për të

gjitha industrinë dhe të rezervuara për ndërmarrjet e regjistruara me orientim nga eksporti, ku vendet në zhvillim e sipër i përdorin këto zona për të stimuluar eksportet.

Koncepti kryesor i zonave të trajtimit të eksporti ishte konceptuar në fillim të viteve 1970 për të nxitur rritjen e eksportit të biznesit në Indi. ZTE-të e Indisë u krijuan për të ndihmuar në rritjen e mallrave të eksportit indian, sidomos nga sektorët me rritje të shpejtë. Ndërsa vende të ndryshme shembull Malajzia, Mauritius dhe Singapori kanë arritur të zhvillojnë një gamë të gjerë të industrive vendase të eksportit në bazë të zhvillimit dhe investimeve mbi këtë lloj të zonave. Lehtësirat e ndryshme dhe kostot e ulëta të hyrjes tërheqin industrinë e prodhimit dhe te përpunimit për të investuar në zona, ata gjithashtu kanë tendencë që të jenë në gjendje apo të gatshëm për të investuar në aftësitë e reja, teknologji apo përmirësim të produktivitetit.

Zonat Ekonomike Speciale (ZES)

Janë të definuara si zona gjeografike të qeverisura nga një organ i menaxhmentit mbikëqyrës, që ofrojnë kushte dhe stimuj të veçantë të tregtisë për firmat të cilët zgjedhin që fizikisht të jenë të vendosura brenda tyre. Pavarësisht dallimeve në nomenklaturë, secila vepron për të rritur tregtinë e rajonit përkatës të saj duke ofruar stimuj të veçantë të tregtisë për të stimuluar investimet vendore dhe të huaja.

Këto zona në përgjithësi janë zbatuar për të përmbushur politikat fiskale, sociale dhe infrastrukturore. Qëllimi fiskal është që të lehtësojë rritjen ekonomike përmes përdorimit të tarifave të reduktuara dhe më efikase të kontrolleve doganore.

Zonat e specializuara janë themeluar për të promovuar produktet shumë teknike dhe shërbime unike për një industri. Shumë prej këtyre zonave fokusohen në prodhimin dhe promovimin e shkencës dhe teknologjisë.

“Dubai Internet City” është një zonë e specializuar që fokusohet vetëm në zhvillimin e softuerëve dhe internet – bazuar në shërbime.

“Labuan” në det të hapur Qendra Financiare në Malajzi është një tjetër shembull i një zone të specializuara për zhvillimin e shërbimeve financiare.

Karakteristikat e suksesshme të ZES-it

Pavarësisht numrit të madh të zonave ekonomike speciale (ZES) në të gjithë globin, shumica e ZES janë të përqendruara vetëm në disa vende. Kina ka qenë më e suksesshme në zbatimin e ZES dhe më profitabile në funksionimin e tyre. Shumica e ZES në Kinë janë shumë të mëdha dhe të specializuara në një gamë të ngushtë të produkteve apo shërbimeve – ato që janë më të favorshme për një mjedis të prodhimit.

Nxitjet në ZES

Qëllimi i një ZES është që të sigurojë korporatat globale me një nxitje për të investuar në zhvillimin dhe infrastrukturës së një vendi të huaj përmes përdorimit të një mjedisi më të favorshëm lidhur me taksat. Reduktimi i taksave të kompanive të vendosura në këto zona do të ketë një përfitim të drejtpërdrejtë pozitiv në të ardhurat e tyre.

Partenriteti publiko – privat i ZES

Fillimisht ZES -et ishin të sponsorizuara nga qeveria, përkatësisht projekte të destinuara për të nxitur investimet në përgjithësi e veçanërisht ato të huaja.

Sfidat e ZES

Zhvillimi i ZES nuk ka ardhur pa shpenzime të mëdha . Një nga arsyet për suksesin e investitorëve në disa ZES është që ata janë të shmangur nga shpenzimet e disa lloje të tatimeve, sigurinë, mbikëqyrjen dhe rregulloret mjedisore.

Përfitimet ZES

Edhe pse zhvillimi i ZES sjellë sfida në vendet pritëse, ato sjellin edhe përfitime të vlefshme. Siç janë vënë në dukje tashmë, përfitimet e një ZES janë që të ndihmojë zgjerimin e bazës industriale të vendit nga industrinë e huaja.

Zonat e Lira Ekonomike

Paraprijës i Zonave të lira ishin Portat e lira doganore, të cilat ishin formuar në qytetet e mëdha evropiane me qëllim të sigurimit të qarkullimit sa më të shpejtë dhe më efikas të mallrave. Në portat e lira doganore mallrat ishin deponuar pa formalitete doganore, janë importuar dhe eksportuar.

Porta e parë e lirë doganore është themeluar në vitin 1189, kur perandori romak Frederiku I-rë lëshoi dekretin, me të cilin qyteti i Hamburgut lirohej nga obligimet doganore, që kryesisht deponoheshin mallrat e destinuara për import në Gjermani, ku qarkullimi i mallrave dhe deponimi i tyre ishin të liruara nga pagesa dhe formalitetet doganore. Dogana paguhej vetëm atëherë kur malli plasohet në tregun gjerman. Në kohën e Mesme hapen një varg portash të lira, siç është ai i: Brixhit, Antverpenit, Amsterdami, Marsejit, Londrës, Gjënovës etj.

Zhvillimi i zonave të lira ka shënuar rritje të veçantë në vitet e 80-ta, kështu, p.sh. në vitin 1982, në botë kanë ekzistuar më shumë se 350 zona të lira, prej të cilave 2/3 ishin të lokalizuara në vendet në zhvillim e në to ishin të punësuar së paku 6 milionë punëtorë.

Zona e lirë e Triestes

Është themeluar më 1928, qëllimi kryesor i saj ishte që duke i orientuar mallrat përmes kësaj Zone të lirë, të ndikohet në shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve deponuese, komunikacionit dhe të transportit. Kjo zonë ka një pozicion shumë të mirë gjeografike dhe ndodhet në mes të Evropës.

Aftësia për të tërhequr dhe nxitur nismat e reja ekonomike është e lidhur ngushtë me bashkëjetesën e kushteve mjedisore, kulturore, sociale, institucionale dhe financiare. Këto janë një grup i faktorëve dallues që mundësojnë burimet e saj aktuale, që të rrit konkurrencën.

Zonat e lira Tregtare (Free Trade Zone)

Një zonë tregtare është një hapësirë e destinuar për biznese, por pa popullsi banuese në të. Zonë e Lirë Tregtare (ZLT) të quajtur edhe Zonë e tregtisë së huaj, që mund të përkufizohet si qendër intensive e punës prodhuese që përfshijnë importin e lëndëve të para dhe eksportin e produkteve dhe që janë të rrethuara në zonat e duty-free, duke ofruar deponimin-magazinimin, ruajtjen dhe duke përfshirë objekte për distribuim tregtar, tregtisë transite dhe shërbimet e ri-eksportit. Qëllimi kryesor i një ZLT është zvogëlimi apo eliminimi i barrierave tregtare dhe ulja e kërkesave burokratike apo edhe rregulloret komplekse doganore me shpresën e tërheqjes së biznesit të ri (ndërmarrësve) dhe të investitorëve të huaj. Zona e parë e botërore e ZLT u krijua në Shannon, Co Clare, Irlandë¹. Kjo ishte një përpjekje nga Qeveria e Irlandezëve për të promovuar punësimin brenda një zone rurale dhe ishte jashtëzakonisht e suksesshme dhe e cila vepron edhe sot.

Zhvillimi dhe vlerësimi i zonave ekonomike në nivel botëror

Performanca ekonomike dhe ndikimi i programeve të zonave ekonomike në vendet në zhvillim është vlerësuar në studime të shumta. Shumica e këtyre, megjithatë, janë përqendruar në zona që janë të zhvilluara dhe të drejtuara nga qeveria dhe kanë lënë pas dore në masë të madhe ndikimin ekonomik të zhvillimit të zonave private.

Zonat janë parë si mjete shumë efektive për gjenerimin e vendeve të punës, veçanërisht për gratë që bëhen pjesë e fuqisë punëtore. Evidencat tregojnë se zonat e tilla janë një burim shumë më i rëndësishëm i punësimit në vendet më të vogla me popullsi me më pak se 5 milionë (shembujt përfshijnë Mauritiusin, Seychelles-et dhe Xhamajkën), sesa në vendet e mëdha.

Zonat Ekonomike gjithashtu, kontribuojnë në zhvillimin e eksportit, jo vetëm në drejtim të përshpejtimit të rritjes së eksportit, por edhe diversifikimit të eksportit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për vendet më pak të zhvilluara për eksportin e produkteve primare. Përveç kësaj, zonat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në tërheqjen e investimeve të huaja direkte, duke ofruar infrastrukturë moderne të rangut botëror dhe politikat nga praktikatat më të mira.

Qëllimi për zhvillimin e rritjes së furnizimit dhe lidhjeve të tjera nëpërmjet përdorimit të zonave të lira duket të jetë i rëndësishëm, për shkak të një nxitjeje më të madhe për firmat lokale për të shitur mallrat dhe shërbimet për ndërmarrjet e vendosura në zonë.

Arritja e një ekuilibri të përshtatshëm buxhetor mund të jetë jo i sigurt për vendet ku ndodhet zona dhe këtu mund të kuptohet dallimi midis fitimit dhe humbjeve.

¹ Zona e Lirë Shannon , Irland www.shannonireland.com

Ka shqetësime të vazhdueshme në lidhje me kushtet e punës dhe mbrojtjes sociale, duke përfshirë të drejtat e grave në disa vende. Megjithatë, pagat dhe kushtet e punës kanë tendencë të jenë më mirë brenda zonës sesa jashtë tyre.

Në vlerësimin e ndikimit në mjedis, ka një dallim që duhet të merret në konsideratë midis ZE për fabrikat individuale dhe zonat industriale në formë të parqeve. Është shumë më e vështirë për qeveritë që në mënyrë adekuate të zbatojnë ligjet-standardet mjedisore për ZE apo fabrikat individuale, pasi ato janë të shpërndara gjerësisht në territorin e vendit.

Zonat Ekonomike Botërore janë zhvillues global dhe operator i zonave ekonomike, teknologjike, logjistikës dhe parqeve industriale në kuadër të Grupit Botërore Dubai. Kompania synon të krijojë një rrjetë të fortë të platformave të infrastrukturës së këtyre zonave dhe parqeve të gjithë botën me një objektiv për të mbështetur zgjerimin dinamik të bazës me shpejtësi në rritje të konsumatorëve të saj ndërkombëtar.

6. Zonat ekonomike nëpër vende të ndryshme të Botës

Kina

Zona e parë ekonomike dhe njëkohësisht dhe më e famshmja në botë është Shenzhen e themeluar nga Republika Popullore e Kinës në fillimin e viteve 80. Kjo zonë u zhvillua nga një fshat i vogël në një qytet me një popullsi prej 10 milionë banorësh brenda 20 vitesh, që është pasojë direkte e themelimit të zonës ekonomike. Si rezultat i krijimit të zonës ekonomike, Shenzhen është tani një ndër qytetet më të pasura në Kinë. Është një qendër shumë e madhe e prodhimit dhe qendër e kompanive më të suksesshme high-tech të Kinës.

Këshilli i Shtetit të Kinës ka miratuar zgjerimin e Shenzhen në Zonë të posaçme ekonomike (Zes) në një përpjekje për të përshpejtuar zhvillimin e saj. Legjislatura e qytetit lulëzon në jug të Kinës.

Bullgaria

Zhvillimi i zonave industriale është një faktor i rëndësishëm për tërheqjen e ndërmarrjeve të reja të prodhimit. Shteti bullgar është duke stimuluar investimet në “ Green Field-Fusha të Gjelbërta” për tërheqjen e investitorëve të rinj përmes një sistemi të stimujve të bazuar kryesisht në aktin e nxitjes së investimeve.

Një nga shembujt më të mirë të suksesshëm të partneritetit publik-privat është Zona Industriale në Rakovski, e cila është e vendosur afër qytetit të Plovdivit. Sipas ekspertëve, për Zonën Industriale në Rakovski, zhvillimi i së cilës ka filluar në mes të 2004, ka mjaft të interesuar deri më tani dhe i ka të gjitha dispozitat për tu bërë Zona numër një në Bullgari.

Maqedonia

Shumica e prodhimit industrial në vitet e ardhshme do të jetë në zonat e lira ekonomik, gjë që do të ndikojë ekonominë, thonë ekonomistët. Duke krijuar punë dhe duke rritur eksportet, zonat

e lira ekonomike do të rritin begatinë e brendshme dhe do të frenojnë rrjedhjen e trurit në Maqedoni.

Për Evropën Juglindore, që ka rreth 10 zona me taksa të posaçme anembanë Maqedonisë, Shqipërisë dhe Serbisë, kjo do të thotë më shumë stabilitet rajonal. Zonat ekonomike në vende si Maqedonia, Shqipëria, Serbia do të fitojnë mjaft, jo vetëm ekonomikisht por edhe politikisht. Zonat sollën mjaft punë të reja në vend, kanë rritur sektorin e ndërtimit dhe do të rritin prirjen e përgjithshme pozitive në të ardhmen.

Maqedonia aktualisht ka katër zona teknike industriale: zonat 1 (Bunarxhik) dhe TIRZ 2 në Shkup dhe nga një në Shtip dhe Tetovë.

Investitorët në zonat e lira nuk paguajnë TVSH dhe janë të përjashtuar nga taksa mbi të ardhurat dhe taksa mbi të ardhurat personale për dhjetë vjet që nga fillimi i tyre. Investitorët e huaj në zonat janë gjithashtu të përjashtuar nga pagimi i 5 deri 20% të detyrimeve doganore për importin e mallrave, materialet e papërpunuara dhe pajisjet.

Vlera totale e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara vitin e kaluar në zonat e lira në Maqedoni u rrit nga 29.13% vitin e kaluar, duke arritur në 1.3 milion euro.

Aktualisht në fabrikat e katër zonave punojnë 1,150 njerëz, por ky numër pritet të rritet në 3,500 punonjës në katër vitet e ardhshme.

Sipas Drejtorisë së Maqedonisë për Zonat e Zhvillimit Teknologjik e Industrial, plani është të hapen shtatë zona të tjera të lira ekonomike në Prilep, Gevgelija, Strumicë, Kërçovë, Rankovce, Strugë dhe Radovish. Zonat do të kontribuojnë në rritjen e ardhshme ekonomike në vendet. Në zonat e reja, ato do të sjellin teknologjitë e reja dhe do të modifikojnë strukturën e eksporteve, por gjithashtu vendet ku ato eksportojnë.

Mali i Zi

Mali i Zi ka miratuar ligjin për krijimin apo themelimin e zonave ekonomike të lira tregtare në vitin 2004. Ligji lejon lëvizjen e lirë të mallrave, kapitalit dhe punës në zona të tregtisë së lirë dhe ofron disa përfitime për investitorët së bashku me përjashtimin nga taksat, doganat dhe detyrave tjera. Mallrat dhe shërbimet që hyjnë në zonat e lira të tregtisë janë të përjashtuar nga TVSH-ja. Aktualisht, ka vetëm një zonë të tregtisë së lirë, e themeluar nga shteti brenda në Portin e Tivarit, e cila është pjesë e doganave në territorin e vendit. Territori i zonës përfshin gjithë zonën e portit të Tivarit me mundësinë e zgjerimit territorial në drejtim të zonave kufitare².

Shqipëria

Në Shqipëri historiku i zonave ekonomike fillon me përpjekjet për hartimin e kuadrit përkatës ligjor. Iniciativa për zhvillimin e Zonave Ekonomike gjenë shprehjen e saj procedurale në

² http://www.rciproject.com/other6_files/SEEINV~B.PDF

Ligjin për Zonat Ekonomike dhe konceptin e saj juridik në Ligjin e Koncesioneve. Kuadri ligjor bazë, Ligji i Koncesioneve si dhe Ligji për Zonat Ekonomike inkorporon praktikën më të mirë procedurale në zhvillimin e kësaj iniciative, duke qenë plotësisht konform legjislacionit evropian të ndihmës shtetërore për sa i përket trajtimit të Zonave të Lira Ekonomike.

Aktualisht, në Shqipëri janë shpallur 7 zona ekonomike. Zona e parë ekonomike është shpallur në Koplík, Shkodër me statusin “Park Industrial” me VKM nr. 12, datë 4.01.2008. Zona shtrihet në një sipërfaqe prej 61 ha me pronësi shtetërore. Aktivitetet që do të ushtrohen janë prodhuese, industriale, agropërpunimi, tregtare, eksport- importi dhe ndihmëse. Më tej kemi zonat:

Zona Ekonomike me statusin “Parku Industrial” në Shëngjin, Lezhë e shpallur me VKM nr. 11, datë 4.01.2008 . Zona shtrihet në një sipërfaqe prej 3.2 ha me pronësi shtetërore. Aktivitetet që do të ushtrohen janë prodhuese, industriale, agropërpunimi, tregtare, eksport- importi dhe ndihmëse.

Zona Ekonomike me statusin “Parku Industrial” në Spitalë, Durrës e shpallur me VKM nr. 391, datë 21.02.2008. Sipërfaqja e Parkut Industrial është 850 ha me pronësi shtetërore dhe private. Aktivitetet që do të ushtrohen janë prodhuese, industriale, agropërpunuese, tregtare, shërbimi.

Zona Ekonomike me statusin “Parku Industrial” në Vlorë e VKM nr. 774, date 04.06.2008. Zona shtrihet në një sipërfaqe prej 125 ha me pronësi shtetërore. Aktivitetet që do të ushtrohen janë prodhuese, industriale, tregtare, import-eksport, shërbime, etj.

Në kuadrin ligjor të sipërm përcaktohet se:

1. “Zonë ekonomike” është një territor, që ka një status të veçantë ekonomik, që mund të jetë zonë e lirë ose park industrial, sipas përcaktimeve të mëposhtme.
2. “Zonë e lirë” është një sipërfaqe e përcaktuar trualli apo ndërtesash dhe pasurish të tjera të paluajtshme, me veprimtari prodhuese, të tregtimit dhe të shërbimeve, që vlerësohet pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, e ndarë nga ky territor, në aspektin e regjimit fiskal dhe doganor dhe që rregullohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
3. “Park industrial” është një territor i ndarë, në përputhje me një plan të përgjithshëm, i pajisur me infrastrukturën e nevojshme, si rrugë, shërbime transporti dhe publike, me ose pa ndërtesa industriale, të ngritura paraprakisht, i destinuar për zhvillim industrial.
4. “Zhvillues” është çdo person juridik, i licencuar, vendas ose i huaj, i cili ndërton, administron dhe monitoron funksionimin e zonës ekonomike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
5. “Operator” është çdo person juridik, vendas ose i huaj, i cili vepron brenda kufijve të zonës ekonomike, me cilësinë e menaxhuesit, nëpërmjet një marrëdhënie kontraktuale, të lidhur ndërmjet tij dhe zhvilluesit, marrëdhënie e cila nuk është objekt i këtij ligji.

7. Vlerësimi i sektorëve aktual dhe potencial të investimeve në kuadër të parqeve Industriale duke theksuar avantazhet e tyre konkurruese

Kosova ka zhvilluar një diversitet të sektorëve në parqet industriale, duke përfshirë prodhimin farmaceutik, metalpunimin, dhe riciklimin e plastikës, të mbështetur nga infrastruktura e avancuar dhe investimet publike të konsiderueshme.

Avantazhet konkurruese përfshijnë qiratë e ulëta dhe mbështetjen e fortë publike, duke krijuar një mjedis tërheqës për investitorët. Sektorët potencialë për investime përfshijnë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, bioteknologjinë, dhe energjinë e rinovueshme, me perspektiva rritjeje të bazuara në zhvillimin e vazhdueshëm të infrastrukturës, promovimin e investimeve, dhe bashkëpunimin me institucionet kërkimore. Këto elemente përbëjnë bazën për një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe për tërheqjen e investimeve të reja.

8. Analiza dhe vlerësimi mbi fuqinë punëtore, përfshirë ndikimin në rritjen e prodhimit, punësimin sipas kualifikimit, gjinisë dhe moshës

Publikimi: “Statistikat e arsimit në Kosovë 2022-2023” është rezultat i bashkëpunimit në ndërmjet të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Burim i të dhënave për arsimin parauniversitar është Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA). Në këtë publikim nuk janë përfshirë të dhënat statistikore të komunitetit serb, me përjashtim të të dhënave për komunën e Kamenicës, të cilët raportojnë në SMIA. Të dhënat për arsimin universitar publik dhe privat i ka siguruar ASK.

Publikimin “Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022-2023” mund ta gjeni edhe në ueb faqe të MASHTI-t: <http://masht.rks-gov.net/> dhe në ueb faqe të ASK-së: <http://ask.rks-gov.net>

“Statistikat e arsimit në Kosovë 2022-2023” përmban të dhëna për:

- numrin e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe parafillor sipas gjinisë, nacionalitetit, grupmoshave dhe personelin arsimor për këtë nivel;
- numrin e nxënësve në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët sipas gjinisë, nacionalitetit, klasave dhe personelin arsimor për këtë nivel;
- numrin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë sipas gjinisë, nacionalitetit, shkollave profesionale/gjimnaze dhe personelin arsimor për këtë nivel;
- numrin e fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta sipas gjinisë, klasave dhe sipas llojit të dëmtimit-vështirësive;
- numrin e studentëve në arsimin universitar sipas gjinisë, nacionalitetit, fakulteteve/programeve të studimit, nivelit të studimit (bachelor dhe master), numrin e të diplomuarve në nivelet bachelor dhe master, stafin akademik etj.

Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët

Arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët përfshijnë nivelet 1 dhe 2 të – SNKA-së, konkretisht klasat 1-9 dhe është arsim i obliguar.

Tabela 4. Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët

Komuna	Meshkuj	Femra	Total
Deçan	1,858	1,729	3,587
Dragash	1,289	1,176	2,465
Ferizaj	7,561	7,477	15,038
Fushë Kosovë	4,282	4,052	8,334
Gjakovë	5,427	5,060	10,487
Gjilan	5,144	5,044	10,188
Glllogoc	4,005	3,735	7,740
Hani i Elezit	673	607	1,280
Istog	2,294	2,212	4,506
Junik	238	201	439
Kaçanik	2,185	1,994	4,179
Kamenicë	1,259	1,199	2,458
Klinë	2,448	2,407	4,855
Leposaviq	12	4	16
Lipjan	4,319	3,925	8,244
Malishevë	3,891	3,577	7,468
Mamushë	352	325	677
Mitrovicë	5,042	4,800	9,842
Novobërdë	244	243	487
Obiliq	1,471	1,405	2,876
Pejë	5,861	5,618	11,479
Podujevë	5,471	5,264	10,735
Prishtinë	14,919	14,428	29,347
Prizren	10,090	9,396	19,486
Rahovec	3,069	2,926	5,995
Shtërpcë	168	160	328
Shtime	1,892	1,704	3,596
Skenderaj	3,053	2,801	5,854
Suharekë	3,470	3,040	6,510
Viti	2,600	2,519	5,119
Vushtrri	4,747	4,352	9,099
Zubin Potok	45	40	85
Zveçan	37	34	71
Klllokot	46	51	97
Gjithsej	109,462	103,505	212,967

Burimi ASK: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/ce374238-1ad6-4665-a295-27b8e9edcaea.pdf>

Tabela 5. Numri i nxënësve në shkolla profesionale dhe gjimnaze

Komuna	Shkolla Profesionale			Gjimnaze			Gjithsej		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Deçan	267	132	399	252	331	583	519	463	982
Dragash	144	169	313	62	62	124	206	231	437
Ferizaj	1,484	1,535	3,019	1,231	1,265	2,496	2,715	2,800	5,515
Fushë Kosovë	412	277	689	274	412	686	686	689	1,375
Gjakovë	1,131	1,007	2,138	615	643	1,258	1,746	1,650	3,396
Gjilan	1,076	1,158	2,234	827	861	1,688	1,903	2,019	3,922
Gllugoc	816	583	1,399	303	529	832	1,119	1,112	2,231
Hani i Elezit	-	-	-	122	143	265	122	143	265
Istog	410	155	565	293	411	704	703	566	1,269
Junik	0	-	-	86	82	168	86	82	168
Kaçanik	313	93	406	224	349	573	537	442	979
Kamenicë	226	93	319	165	230	395	391	323	714
Klinë	421	251	672	250	362	612	671	613	1,284
Leposaviq	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Lipjan	601	245	846	592	857	1,449	1,193	1,102	2,295
Malishevë	470	323	793	443	757	1,200	913	1,080	1,993
Mamushë	-	-	-	67	61	128	67	61	128
Mitrovicë	1,188	1,229	2,417	426	625	1,051	1,614	1,854	3,468
Novobërdë	20	30	50	-	-	-	20	30	50
Obiliq	256	83	339	91	198	289	347	281	628
Pejë	1,230	867	2,097	642	872	1,514	1,872	1,739	3,611
Podujevë	1,187	753	1,940	513	907	1,420	1,700	1,660	3,360
Prishtinë	2,552	1,725	4,277	1,895	2,946	4,841	4,447	4,671	9,118
Prizren	2,089	1,641	3,730	816	1,279	2,095	2,905	2,920	5,825
Rahovec	224	167	391	488	441	929	712	608	1,320
Shtërpçë	8	1	9	48	41	89	56	42	98
Shtime	251	141	392	277	295	572	528	436	964
Skenderaj	774	535	1,309	225	371	596	999	906	1,905
Suharekë	702	477	1,179	297	464	761	999	941	1,940
Viti	332	130	462	383	557	940	715	687	1,402
Vushtrri	1,038	584	1,622	270	495	765	1,308	1,079	2,387
Zubin Potok	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Zveçan	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Klllokot	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	19,622	14,384	34,006	12,177	16,846	29,023	31,799	31,230	63,029

Burimi ASK: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/ce374238-1ad6-4665-a295-27b8e9edcaea.pdf>

Numër më i madh i studentëve të regjistruar për herë të parë në arsimin e lartë në nivelin Bachelor është shënuar në fushat “Biznes, administratë dhe ligj” me gjithsej 4268 studentë ose 25,0% e numrit të përgjithshëm të studentëve. Ndërsa, numër më i vogël i studentëve janë regjistruar në fushat “Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinar” me gjithsej 365 studentë ose 2,1%. Po ashtu, vërehet numër i vogël i studentëve të cilët kanë zgjedhur të studiojnë në fushën e “Arsimit” me gjithsej 390 ose 2,3%.

Tabela 6. Fusha e Studimit

Fusha e studimit	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Arsimi	366	24	390
Arte dhe shkenca humane	1469	616	2085
Shkencat shoqërore, gazetari dhe informim	1450	335	1785
Biznes, administrata dhe ligji	2283	1985	4268
Shkencat natyrore, matematikë dhe statistikat	345	164	509
Teknologjia Informative dhe Komunikimi (TIK)	871	1830	2701
Inxhinieri, prodhimi dhe ndërtimi	903	1068	1971
Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinar	230	135	365
Shëndeti dhe mirëqenia	1844	618	2462
Shërbime	178	338	516
Gjithsej	9939	7113	17052

Burimi ASK: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/6c832db1-dbad-452d-a347-2ccfb224f823.pdf>

Hulumtimi nga intervistat e realizuara me 120 biznese aktive të zonave ekonomike në Kosovë

Pjesa e mëposhtme e këtij studimi, përmban të dhënat nga intervistat e realizuara me 120 nga 132 bizneset aktive të zonave ekonomike në Kosovë. Këto intervista janë realizuar duke përdorur pyetësin e cili kryesisht ka qenë i përbërë nga pyetje demografike të dhëna për biznesin si dhe pyetje të tjera të cilat kanë pas për qëllim të nxjerrin informata të hollësishme lidhur me gjendjen aktuale të bizneseve, numrin e të punësuarve, llojin e investimit etj. Tutje në këtë studim janë paraqitur të dhënat nga pyetësi i realizuar.

a. Analiza e të dhënave të fuqisë punëtore në Parqet Industriale në Kosovë

Nga 132 bizneset e vendosura në parqet industriale prej tyre kemi intervistuar 120 biznese. Bazuar në përgjigjet e 120 bizneseve aktive të intervistuar në parqet industriale në Kosovë, kemi përpiluar një analizë të detajuar të fuqisë punëtore. Këto të dhëna përfshijnë shpërndarjen e numrit të punonjësve, përfaqësimin gjinor, moshën dhe kualifikimin e tyre.

b. Numri i punonjësve në zonat ekonomike

Numri total i punonjësve në parqet industriale nga 120 bizneset aktive të intervistuar është 3063. Shpërndarja e bizneseve sipas numrit të punonjësve tregon se:


- **1 - 9 punëtor:** 36 biznese (30%)
- **10 - 49 punëtor:** 72 biznese (60%)
- **50 – 249 punëtor** – 11 biznese (9.17%)
- **250+ punëtor** – 1 biznes (0.83%)

Tabela 7. Përfaqësimi gjinor

4. Si është përfaqësimi gjinor i fuqisë punëtore të zonave ekonomike në komunën tuaj?	Numri i punëtorëve	Përqindja
Femra	540	18%
Meshkuj	2523	82%
Total	3063	100%

Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Figura 3. Përfaqësimi gjinor i fuqisë punëtore



Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Në aspektin e përfaqësimit gjinor, të dhënat tregojnë përqindje të lartë të meshkujve në fuqinë punëtore (afërsisht 82%) tregon një pabarazi gjinore të dukshme në Parqet Industriale. Kjo pabarazi mund të reflektojë sfida sociale dhe kulturore që mund të ekzistojnë në integrimin e femrave në tregun e punës.

c. Moshë e fuqisë punëtore

Moshë e punonjësve është shpërndarë si vijon:

Tabela 8. Moshë e fuqisë punëtore

5. Moshë e fuqisë punëtore të zonave ekonomike në komunën tuaj?	Numri i punëtorëve	Përqindja
Të rinj 18-30 vjeç	910	29.71%
Moshë e mesme 31-50 vjeç	1796	58.64%
Mbi 50 vjeç	357	11.66%
Total	3063	100%

Shumica e fuqisë punëtore (rreth 59%) është në moshën e mesme, 31-50 vjeç, që është një tregues pozitiv për stabilitetin dhe përvojën e fuqisë punëtore. Megjithatë, prania e konsiderueshme e të rinjve (rreth 30%) tregon një potencial të mirë për zhvillimin e mëtejshëm të fuqisë punëtore.

d. Kualifikimi i punonjësve

Kualifikimi i punonjësve është shpërndarë në këto kategori:

- **Punonjës me arsim të lartë:** 858 punonjës (28,01%)
- **Punonjës me arsim të mesëm:** 1819 punonjës (59.39%)
- **Punonjës pa arsim formal:** 386 punonjës (12.60%)

Këto të dhëna tregojnë se shumica e fuqisë punëtore ka një nivel të arsimit të mesëm (59.39%), që është tipike për shumë zona industriale. Përqindja e punonjësve me arsim të lartë (28.01%) është gjithashtu e rëndësishme, duke treguar një prani të ekspertëve dhe profesionistëve në zonat ekonomike. Një pjesë e vogël e punonjësve (12.60%) nuk kanë arsim formal, që mund të sugjerojë nevojën për programe të trajnimit dhe zhvillimit të aftësive.

9. Analiza dhe vlerësimi mbi përfitimet dhe sfidat socio-ekonomike me të cilat përballen komunitetet përreth dhe rajonit

Zonat ekonomike në Kosovë kanë sjellë një sërë përfitimesh socio-ekonomike për komunitetet përreth dhe rajonin në tërësi. Krijimi i vendeve të reja të punës është një nga përfitimet më të mëdha, duke kontribuar në uljen e papunësisë dhe përmirësimin e standardit të jetesës. Rritja ekonomike në këto zona ka sjellë gjithashtu një rritje të të ardhurave për komunitetet lokale, duke mundësuar përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe shërbimeve publike. Përveç kësaj, zonat ekonomike kanë kontribuar në diversifikimin e ekonomisë lokale dhe kanë krijuar mundësi për bashkëpunim ndërmjet biznesit dhe institucioneve edukative, duke promovuar kështu zhvillimin e aftësive dhe trajnimin profesional. Diversifikimi ekonomik në komunat ku janë ndërtuar Parqet Industriale dhe Teknologjike ka evoluar në mënyrë të ndjeshme. Më parë, ekonomitë e këtyre komunave ishin kryesisht të bazuara në bujqësi dhe industri të vogla, me pak mundësi për zhvillim të sektorëve të tjerë. Për shembull, Komuna e Drenasit ishte e njohur për aktivitete të kufizuara industriale, ndërsa pas krijimit të Parkut të Biznesit, u rrit pjesëmarrja e industrive të përpunimit dhe prodhimit. Në Mitrovicë, ekonomia ishte më shumë e përqendruar në miniera dhe industri të lidhura me burimet natyrore. Sot, Parku i Biznesit ka ndihmuar në zhvillimin e sektorëve të rinj, si prodhimi i materialeve ndërtimore dhe përpunimi i metaleve. Ndërkohë, në Suharekë, zona ishte e përqendruar kryesisht në bujqësi, por pas ndërtimit të Parkut Industrial, janë zhvilluar industri të përpunimit të ushqimit dhe prodhimit tekstil, duke krijuar mundësi të reja për banorët dhe biznese.

Megjithatë, ka edhe sfida të rëndësishme socio-ekonomike me të cilat përballen komunitetet përreth. Ndikimi mjedisor i zhvillimit industrial mund të jetë një shqetësim, duke përfshirë ndotjen e ajrit dhe ujit, si dhe degradimin e tokës. Për më tepër, integrimi i fuqisë punëtore

lokale në zonat ekonomike mund të jetë sfidues për shkak të mungesës së aftësive specifike që kërkohen nga industritë e reja. Ekziston gjithashtu rreziku i pabarazisë ekonomike për bizneset e vendosura në zona ekonomike me ato jashtë zonave ekonomike, ku përfitimet ekonomike mund të mos shpërndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet bizneseve. Sfida të tjera përfshijnë presionet mbi infrastrukturën ekzistuese dhe shërbimet publike për shkak të rritjes së shpejtë ekonomike dhe migrimit të popullsisë drejt zonave urbane.

Në përmbledhje, ndërsa zonat ekonomike në Kosovë kanë potencial të madh për të përmirësuar jetën socio-ekonomike të komuniteteve përreth, është thelbësore që të adresohen sfidat mjedisore dhe sociale për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të drejtë.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin “Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet në Kosovë mars 2024”, i cili përmban të dhëna statistikore për bizneset e regjistruara tek Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK). Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB) është pjesë e ASK-së i cili përmban informacionet themelore për të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitetin ekonomik në territorin e Republikës së Kosovës dhe si i tillë shërben për statistika dhe analiza të demografisë së bizneseve, përgatitjen e mostrave dhe ngritjen e rezultateve në nivel vendi për të gjitha anketat që realizohen me bizneset.

Përkufizime dhe definicione

Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE), është klasifikim në nivel katër shifror i veprimtarive ekonomike të ushtruara në subjekte të ndryshme. Kjo nomenklaturë është përkthim dhe përshtatje e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të Komunitetit Evropian (NACE Rev.2. në Gjuhën Angleze). Përdorimi i kësaj nomenklature është obligative që nga data 1 shtator 2014 në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe bazohet në rregulloren Nr.11/2013 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Struktura e veprimtarive ekonomike NACE Rev. 2 përbëhet nga 21 seksione të cilat janë prezantuar me poshtë të emërtuar me shkronja nga A deri tek U.

- A Bujqësi, pylltari dhe peshkatari
- B Xehetari dhe gurëthyes
- C Prodhim
- D Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar
- E Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash
- F Ndërtimtari
- G Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave
- H Transport dhe ruajtje
- I Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim
- J Informacion dhe komunikim
- K Aktivitete financiare dhe sigurimit
- L Aktivitete të patundshmërisë
- M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
- N Aktivitete administrative dhe mbështetëse
- O Administratë publike dhe mbrojtje
- P Arsim

- Q Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale
- R Art, zbavitje dhe rekreacion
- S Aktivitete të shërbimeve tjera
- T Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës
- U Aktivitete të organizatave dhe organeve jashtë-territoriale.

Klasat e veprimtarive ekonomike sipas nomenklaturës së re NACE Rev. 2 janë gjithsej 615 sosh, të cilat janë të koduar me kodin katër shifror duke filluar nga 0111 deri tek 990.

Tabela 9. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas muajve dhe seksioneve të aktiviteteve ekonomike

		Bujqësi, pylltari dhe peshtatari	Xehetari dhe gurëthyes	Prodhim	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash	Ndërtimtari	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	Transport dhe ruajtje	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	Informacion dhe komunikim	Aktivitete financiare dhe sigurimit	Aktivitete të patundshmerisë	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	Arsim	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	Art, zbavitje dhe rekreacion	Aktivitete të shërbimeve tjera
Muajt	Gjithsej	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S
2023 Janar	876	27	1	112	16	2	93	220	28	62	54	5	8	91	50	1	14	22	20	50
2023 Shkurt	1043	117	1	114	9	2	102	228	27	103	61	7	12	105	53		10	33	14	45
2023 Mars	1166	39	2	130	14	4	128	311	25	107	56	12	17	112	65	1	20	23	27	73
2023 Prill	725	30	1	75	5	2	83	207	14	68	32	10	17	60	53		8	12	12	36
2023 Maj	1024	22	3	99	13	1	105	247	21	98	61	13	25	115	76	1	16	31	24	53
2023 Qershor	909	30	2	111	7	4	96	210	25	92	45	10	12	87	82	1	2	21	15	57
2023 Korrik	996	31	2	84	7	4	90	222	23	111	67	8	12	95	77		17	31	35	80
2023 Gusht	939	17	3	93	7	6	85	187	18	85	64	8	20	120	61	1	13	24	27	100
2023 Shtator	910	18	1	95	6	3	100	203	20	92	47	3	17	118	49	2	14	23	10	89
2023 Tetor	1090	18	4	85	7	4	109	262	28	118	87	11	14	120	83	3	17	38	11	71
2023 Nëntor	924	30	3	93	8	3	91	241	19	66	59	9	24	94	75	3	10	26	12	58
2023 Dhjetor	807	16	2	75	7	3	83	213	29	61	54	5	17	93	61	3	16	17	15	37
2023 Gjithsej	11,409	395	25	1,166	106	38	1,165	2,751	277	1,063	687	101	195	1,210	785	16	157	301	222	749
2024 Janar	998	15	1	109	-	2	132	273	30	73	76	11	16	116	64	-	13	26	9	32
2024 Shkurt	1,029	19	4	114	8	4	102	276	41	85	61	11	17	113	72	1	7	25	23	46
2024 Mars	1,222	119	3	139	10	4	130	300	48	88	77	11	10	104	57	4	8	30	29	51

Burimi ASK, Linku: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/e42e02cf-b149-441b-93a3-2824a2f62f40.pdf>

Tabela 10. Numri i NVM-ve të regjistruara gjatë vitit 2023

Numri i NVM-ve të regjistruara gjatë vitit 2023				
	TM4 2023	TM3 2023	TM2 2023	TM1 2023
Mikro ndërmarrje 1 - 9	2787	2834	2624	3057
Ndërmarrje te vogla 10 – 49	33	18	31	28
Ndërmarrje te mesme 50 – 249	1	0	8	1

Burimi: ASK, Linku: [Numri i NVM-ve sipas klasifikimi / numri i te punesuarve dhe tm / numri i bizneseve. SiteTitle](#)

Duke pasur parasysh bizneset e regjistruara sipas tabelave të mësipërme dhe aktiviteteve që ushtrojnë veprimtaritë në zona ekonomike, del që sektorët aktual dhe potencial të investimeve në kuadër të parqeve industriale janë ata të sektorit C, respektivisht veprimtaritë prodhuese, përfshirë edhe ndërtimin, në këtë rast produktet ndërtimore, si dhe sektori M – aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike, të cilat lidhet me parqet teknologjike dhe lidhshmërinë e tyre me universitetet dhe institutit të hulumtimeve, janë potencial i mundshëm.

10. Analiza dhe vlerësimi mbi të hyrat nga zonat ekonomike përfshirë qiratë, pagat etj

Të ardhurat bruto të punonjësve, që përfshinë të ardhurat për punën dhe kohën e kaluar në punë, të ardhurat e tjera personale, të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje kolektive (shtesat), ose kontratën e punës, në të cilën tatimi mbi të ardhurat personale është zbatuar. Ndryshe, paga bruto është shuma e përgjithshme e pagës pa tatim dhe pa kontributet e zbritura (pension/kursime pensionale, sigurime shëndetësore, etj).

Në vitin 2012, paga mesatare bruto në Kosovë ishte 383 Euro, derisa në vitin 2021 ishte 484 Euro, ndërsa në vitin 2022 kemi rritje në 521 Euro, pra me një rritje me 37 Euro nga viti paraprak. Derisa, paga neto nga 348 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 432 Euro në vitin 2021, ndërsa vitin 2022 kemi rritje në 446 Euro, pra me një rritje prej 14 Euro nga viti paraprak.

Tabela 11. Niveli i pagës mesatare bruto dhe euro, sipas viteve 2012 - 2022

Viti	Kosovë		Sektori Publik		Nder. Publike		Sektori Privat	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto
2012	383	348	407	366	561	502	337	308
2013	386	351	411	370	573	512	340	310
2014	403	365	473	423	656	583	329	301
2015	415	376	509	454	674	598	328	300
2016	422	382	525	467	686	609	340	310
2017	431	390	532	474	699	620	356	324
2018	453	409	573	509	721	639	376	342
2019	477	430	584	519	766	677	411	372
2020	466	416	624	552	769	680	380	342
2021	484	432	612	542	768	680	419	376
2022	521	446	604	536	789	659	473	401

Burimi ASK: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/085019af-7367-4166-966f-87cfcecf3852.pdf>

Ndikimi social i pagave në zonat ekonomike

Në zonat ekonomike funksionale, numri total i punëtorëve është 3063, me një pagë mesatare prej 500 euro në muaj. Kjo nënkupton një qarkullim të përgjithshëm të pagave prej 1,526,500 euro çdo muaj. Kjo shumë përfaqëson një injektim të konsiderueshëm financiar në ekonominë lokale, duke ndihmuar në rritjen e fuqisë blerëse të punëtorëve dhe rrjedhimisht, në nxitjen e zhvillimit ekonomik të rajonit. Ky qarkullim i pagave është një tregues i rëndësishëm i ndikimit ekonomik të këtyre zonave, duke nxitur stabilitetin dhe përparimin ekonomik të komuniteteve përkatëse.

11. Analiza e Shitjeve

Analiza e shitjeve në zonat ekonomike të Kosovës tregon një performancë të fuqishme në rritjen dhe diversifikimin e produkteve dhe shërbimeve nga bizneset e vendosura atje. Nga 120 bizneset e intervistuar, mbi gjysma, përkatësisht 53.33%, kanë raportuar një rritje të ndjeshme në shitje. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i investimeve në kapacitete prodhuese dhe gjetjes së tregjeve të reja, të cilat janë lehtësuar nga infrastruktura e mirë në zonat ekonomike. Për më tepër, 31.67% e bizneseve kanë parë një rritje të lehtë në shitje, duke përfituar nga bashkëpunimi ndërmjet bizneseve dhe aksesimi i mundësive të reja në treg. Vetëm 12.50% e bizneseve nuk kanë përjetuar ndryshime të konsiderueshme, dhe një pjesë shumë e vogël, 2.50%, ka raportuar një ulje në shitje, kryesisht për shkak të konkurrencës ndërkombëtare dhe sfidave me logjistikën.

Një tjetër këndvështrim tregon se rritja e shitjeve në këto zona është ngushtë e lidhur me përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe proceseve prodhuese. 53.33% e bizneseve që kanë përjetuar rritje të ndjeshme kanë përfituar nga një qasje më e lehtë në burime të reja teknologjike

dhe përmirësime të infrastrukturës së transportit, duke i bërë më konkurrues në tregjet ndërkombëtare. Ndërkohë, bizneset që kanë përjetuar rritje të lehtë, 31.67%, e kanë shfrytëzuar infrastrukturën ekzistuese për të rritur produktivitetin, megjithëse ende përballen me sfida në zgjerimin e tregjeve të tyre. Në anën tjetër, 12.50% e bizneseve që nuk kanë përjetuar ndryshime dhe ato 2.50% me ulje në shitje përballen me sfida të brendshme, duke përfshirë mungesën e inovacionit dhe problemet me logjistikën e distribucionit.

Nga këndvështrimi i diversifikimit të tregjeve dhe produkteve, 53.33% e bizneseve kanë raportuar se infrastruktura e përmirësuar dhe mundësitë e bashkëpunimit kanë kontribuar në zgjerimin e produkteve dhe shërbimeve të ofruara. 31.67% kanë përdorur këto zona për të testuar tregje të reja, duke parë një rritje të lehtë në shitje, ndërsa 12.50% janë ende duke luftuar për të gjetur hapësira të reja tregu, pavarësisht infrastrukturës së përmirësuar. Sfidat e mbetura për këto biznese përfshijnë logjistikën e pamjaftueshme dhe presionet nga konkurrenca e jashtme.

Tabela 12. Ndikimi i zonave ekonomike në shitjen e produkteve

Si e vlerësoni ndikimin e zonave ekonomike në shitjet e produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga bizneset?	Përgjigjet e bizneseve	Përqindja
Pa ndryshim	15	12.50%
Rritje e lehtë	38	31.67%
Rritje e ndjeshme	64	53.33%
Ulje	3	2.50%
Total	120	100%

Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

12. Analiza dhe vlerësimi mbi ndikimin e zonave ekonomike në rritjen e eksporteve dhe zëvendësimin e importeve

Zonat ekonomike në Kosovë kanë rritur ndjeshëm eksportet duke diversifikuar prodhimet dhe përmirësuar cilësinë e tyre, duke bërë produktet kosovare më konkurruese në tregjet ndërkombëtare. Lehtësirat fiskale dhe doganore kanë ulur kostot e prodhimit dhe eksportit. Po ashtu, këto zona kanë zëvendësuar importet përmes rritjes së prodhimit vendor, krijimit të vlerave të shtuara lokale dhe reduktimit të kostove të importit. Këto zhvillime kanë forcuar ekonominë lokale dhe kanë kontribuar në një ekonomi më të qëndrueshme dhe të diversifikuar.

Figura 4. Ndikimi i zonave ekonomike në rritjen e eksporteve dhe zëvendësimin e importeve



Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Tabela 13. Ndikimi i zonave ekonomike në rritjen e eksporteve dhe zëvendësimin e importeve

Sa kanë ndikuar zonat ekonomike në rritjen e eksporteve apo zëvendësimin e importeve në komunën tuaj?	Përgjigjet e bizneseve	Përqindja
Aspak	2	1.67%
Mesatarisht	47	39.17%
Pak	4	3.33%
Shumë	67	55.83%
Total	120	100%

Tabela e mësipërme paraqet ndikimin e zonave ekonomike në rritjen e eksporteve dhe zëvendësimin e importeve. Nga 120 biznese të intervistuar, 55.83% raportojnë ndikim të madh, 39.17% ndikim mesatar, 3.33% ndikim të pakët, dhe 1.67% nuk kanë përjetuar ndikim. Kjo tregon se shumica e bizneseve kanë përfituar ndjeshëm nga zonat ekonomike. Disa nga treguesit e mundshëm janë se bizneset duke shfrytëzuar infrastrukturën e gatshme të parqeve industriale, kanë pasur mundësi financiare që të investojnë në shtimin e kapaciteteve prodhuese, marketing, poashtu kanë pasur mundësi të krijojnë bashkëpunime me bizneset tjera brenda parqeve industriale dhe të rrisin sasinë dhe cilësinë e produkteve dhe shërbimeve.

13. Analiza dhe vlerësimi mbi ndikimin e zonave ekonomike në nivel lokal dhe qendror

Ndikimi në nivel lokal:

1. **Krijimi i vendeve të punës:** Zonat ekonomike kanë kontribuar në krijimin e mijëra vendeve të punës për banorët lokalë, duke ulur papunësinë dhe përmirësuar standardet e jetesës.
2. **Rritja e të ardhurave lokale:** Bizneset në këto zona gjenerojnë të ardhura për komunat përmes taksave lokale, qirave dhe tarifave të tjera, që investohen më pas në infrastrukturë dhe shërbime publike.

3. **Zhvillimi i infrastrukturës:** Investimet në infrastrukturën lokale, përfshirë rrugët, furnizimin me ujë dhe energji, kanë përmirësuar cilësinë e jetesës dhe kanë krijuar një mjedis më tërheqës për investime të reja.

Ndikimi në nivel qendror:

1. **Rritja ekonomike:** Zonat ekonomike kontribuojnë në rritjen e përgjithshme ekonomike të Kosovës duke nxitur eksportet dhe zëvendësuar importet, çka ndikon pozitivisht në PBB-në e vendit.
2. **Tërheqja e investimeve të huaja:** Këto zona janë një magnet për investitorët e huaj, të cilët sjellin kapital të ri, teknologji dhe njohuri, duke ndihmuar në modernizimin e ekonomisë së vendit.
3. **Diversifikimi ekonomik:** zonat ekonomike ndihmojnë në diversifikimin e ekonomisë kosovare duke zhvilluar sektorë të ndryshëm si prodhimi, teknologjia dhe përpunimi i ushqimit, duke ulur varësinë nga disa sektorë të veçantë.

Në përfundim, zonat ekonomike kanë një ndikim pozitiv të theksuar si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror, duke përmirësuar jetesën e banorëve lokalë, rritur të ardhurat dhe kontribuar në rritjen dhe diversifikimin e ekonomisë së Kosovës.

14. Pasqyrë mbi administrimin e parqeve industriale dhe teknologjike

Bazuar në ligjin për parqe industriale dhe teknologjike, në nenin 10 parashihet forma e administrimit, ku:

- AIPNK së bashku me Propozuesin për themelimin e Parkut industrial dhe teknologjik e administron parkun, në rastet kur investimi bëhet nga Qeveria, gjë që nuk ka qenë në të kaluarën.
- Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, komuna ose investitori mund të administrojë parkun industrial dhe teknologjik në rastet kur e financon vet ndërtimin dhe funksionalizimin e tij.
- Përgjegjësitë e administruesit të parkut industrial dhe teknologjik, etj.
- AIPNK kryen shërbimet e sekretarisë për Administruesin sipas paragrafit 1, të këtij neni.

Bazuar në gjendjen faktike nga terreni shihet së të gjitha zonat ekonomike administrohen nga komunat përkatëse ku janë të themeluara zonat, përveç parku industrial në Drenas, i cili administrohet nga MINT në bashkëpunim me komunën e Drenasit.

Modelet ndërkombëtare

Shqipëria: Ligji për zonat ekonomike synon krijimin dhe funksionimin e zonave të lira ekonomike për të promovuar zhvillimin ekonomik, tërheqjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës.

Zonat mund të jenë të përgjithshme ose të specializuara në varësi të llojit të aktiviteteve ekonomike të kryera në to.

Zonat krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave pas propozimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe financave, dhe mund të propozohet nga autoritetet qendrore ose lokale, si dhe nga investitorët privatë.

Menaxhimi i zonave të lira ekonomike mund të bëhet nga shoqëritë private të menaxhimit ose nga autoritetet publike, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.

Italia: Ligji kryesor që rregullon zonat ekonomike është Ligji Nr. 91, datë 21.06.2017, i cili krijon dhe rregullon zonat ekonomike të veçanta (Zone Economiche Speciali - ZES). Ky ligj përfshin krijimin, funksionimin dhe menaxhimin e këtyre zonave të veçanta për të tërhequr investime dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik, veçanërisht në rajonet më pak të zhvilluara.

Ligji për zonat ekonomike të veçanta synon krijimin dhe funksionimin e këtyre zonave për të promovuar zhvillimin ekonomik, tërheqjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës, veçanërisht në rajonet jugore të vendit.

Zonat ekonomike të veçanta janë të përcaktuara kryesisht në rajonet jugore të Italisë dhe janë të orientuara drejt zhvillimit ekonomik dhe tërheqjes së investimeve.

Zonat ekonomike të veçanta krijohen me dekret të Presidentit të Republikës pas propozimit të Ministrit të Kohezionit Territorial dhe Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, dhe mund të propozohet nga autoritetet qendrore ose rajonale.

Menaxhimi i zonave ekonomike të veçanta bëhet nga një Komitet Menaxhues, i cili përfshin përfaqësues nga qeveria qendrore, rajonale dhe lokale, si dhe nga sektori privat.

Slovenia: legjislacioni që rregullon zonat ekonomike është i bazuar në Ligjin për Zonat e Veçanta Ekonomike (Zakona o posebnih gospodarskih območjih - ZPGO), i cili krijon dhe rregullon funksionimin e këtyre zonave për të tërhequr investime dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik, veçanërisht në rajonet më pak të zhvilluara.

Ligji për zonat e veçanta ekonomike synon krijimin dhe funksionimin e këtyre zonave për të promovuar zhvillimin ekonomik, tërheqjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës në rajonet më pak të zhvilluara të vendit.

Zonat ekonomike të veçanta janë të fokusuar në zhvillimin ekonomik të rajoneve specifike, me një orientim të veçantë drejt inovacionit dhe teknologjisë.

Zonat ekonomike të veçanta krijohen me vendim të Qeverisë, bazuar në propozimet e ministrisë përkatëse dhe autoriteteve rajonale.

Menaxhimi i zonave ekonomike të veçanta bëhet nga një Komitet Menaxhues, i cili përfshin përfaqësues nga qeveria qendrore, rajonale dhe lokale, si dhe nga sektori privat.

Maqedonia e Veriut: Ligji kryesor që rregullon zonat ekonomike është Ligji për Zonat Teknologjike Industriale Zhvillimore (ZTIZ), i cili synon krijimin e kushteve të favorshme për investimet e huaja dhe vendore, për të promovuar zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe për të përmirësuar eksportet.

Ligji për ZTIZ synon krijimin e zonave teknologjike-industriale me qëllim të tërheqjes së investimeve, nxitjen e zhvillimit teknologjik, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e eksportit.

Zonat janë kryesisht teknologjike-industriale dhe fokusohet në zhvillimin e teknologjisë dhe industrisë për eksport.

Zonat teknologjike-industriale krijohen me vendim të Qeverisë dhe propozimi mund të bëhet nga ministria përkatëse, agjencitë shtetërore, apo nga investitorët privatë.

Zonat menaxhohen kryesisht nga autoritetet publike ose përmes partneriteteve me sektorin privat, me një fokus të veçantë në përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për investitorët.

15. Identifikimi i statusit dhe sipërfaqes së pronave për secilën Zonë Ekonomike

Zonat ekonomike janë struktura të rëndësishme për nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Në Kosovë, krijimi dhe menaxhimi i këtyre zonave luan një rol kyç në zhvillimin industrial dhe ekonomik të vendit. Ky dokument synon të ofrojë një përmbledhje të detajuar dhe profesionale të statusit dhe sipërfaqes së pronave të zonave ekonomike aktuale në Kosovë, duke përfshirë informacione të rëndësishme për çdo zonë, si dhe të dhëna të sakta mbi pronësinë dhe aktivitetet kryesore që zhvillohen në to.

Zonat Ekonomike në Kosovë:

1. Parku i Biznesit në Drenas

- **Statusi:** Shpallur Zonë Ekonomike
- **Pronësia:** Pronat është pronë e komunës së Drenasit.
- **Sipërfaqja:** 24 ha
- **Kategoritë e Veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime

2. Parku i Biznesit në Mitrovicë

- **Statusi:** Shpallur Zonë Ekonomike
- **Sipërfaqja:** 3.50 ha

- **Pronësia:** Prona është në emër të Kuvendit Komunal të Mitrovicës.
- **Kategoritë e Veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime

3. Parku Teknologjik në Shtime

- **Statusi:** Zonë Ekonomike Lokale
- **Sipërfaqja:** 10.70 ha
- **Pronësia:** Prona është në emër të Kuvendit Komunal të Shtimes.
- **Kategoritë e Veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime

4. Parku Industrial në Mitrovicë

- **Statusi:** Zonë Ekonomike Lokale
- **Sipërfaqja:** 48 ha
- **Pronësia:** Prona është në emër të Kuvendit Komunal të Mitrovicës.
- **Kategoritë e Veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime

5. Zona Agro-industriale në Suharekë

- **Statusi:** Shpallur Zonë Ekonomike
- **Sipërfaqja:** 28 ha
- **Pronësia:** Prona është në emër të Kuvendit Komunal të Suharekës.
- **Kategoritë e Veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime

6. Zona Ekonomike në Qylagë, Lipjan

- **Statusi:** Shpallur Zonë Ekonomike
- **Sipërfaqja:** 56 ha
- **Pronësia:** Prona është në emër të Kuvendit Komunal të Lipjanit.
- **Kategoritë e Veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime

7. Zona Ekonomike në Shirokë, Suharekë

- **Statusi:** Shpallur Zonë Ekonomike
- **Sipërfaqja:** 162 ha
- **Pronësia:** Prona është në emër të Kuvendit Komunal të Suharekës.
- **Kategoritë e Veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime

8. Zona Ekonomike në Budrikë, Viti

- **Statusi:** Shpallur Zonë Ekonomike
- **Sipërfaqja:** 15.50 ha

- **Pronësia:** Prona është në emër të Kuvendit Komunal të Vitisë.
- **Kategoritë e Veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime

9. Zona Ekonomike në Lumadh, Vushtrri

- **Statusi:** Shpallur Zonë Ekonomike
- **Sipërfaqja:** 14.86 ha
- **Pronësia:** Prona është në emër të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë.
- **Kategoritë e Veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime

10. Zona Ekonomike në Optrushë, Rahovec

- **Statusi:** Shpallur Zonë Ekonomike
- **Sipërfaqja:** 34.89 ha
- **Pronësia:** Prona është në emër të Kuvendit Komunal.
- **Kategoritë e Veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime

11. Parku Industrial dhe Teknologjik në Livadicë, Podujevë

- **Statusi:** Shpallur Zonë Ekonomike
- **Sipërfaqja:** 29 ha
- **Pronësia:** Pronat janë të regjistruara në emër të Komunës së Podujevës.
- **Kategoritë e Veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime

12. Parku i Përgjithshëm në Drenas

- **Statusi:** Shpallur Zonë Ekonomike
- **Sipërfaqja:** 36.50 ha
- **Pronësia:** Pronat janë të regjistruara në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- **Kategoritë e planifikuara të veprimtarisë:** Prodhim, përpunim, shërbime.

16. ANALIZA SWOT

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga pyetësi për zonat ekonomike, është kryer një analizë SWOT (Forcat, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet). Kjo analizë ndihmon në identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në funksionimin dhe zhvillimin e këtyre zonave.

Tabela 14. Analiza SWOT për Zonat Ekonomike

Përparësitë	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Infrastrukturë e zhvilluar, shumica e zonave ekonomike kanë infrastrukturë të zhvilluar, duke përfshirë rrugët, furnizimin me energji dhe ujë, si dhe lidhje të tjera të nevojshme për bizneset. • Pozicion strategjik, disa nga zonat ekonomike kanë pozicion të favorshëm strategjik, që i bën ato tërheqëse për investitorët. • Përkrahje Qeveritare, përkrahja nga Qeveria, përfshirë edhe incentivat dhe lehtësitë e ofruara për bizneset që vendosen në këto zona. 	<ul style="list-style-type: none"> • Procedurat Administrative, procedurat komplekse janë një ndër pengesat kryesore për bizneset që dëshirojnë të investojnë në këto zona. • Kapacitetet e kufizuara të fuqisë punëtore, mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar është një tjetër dobësi e cila mund të ndikojë në efektivitetin dhe rritjen e bizneseve. • Mungesa e infrastrukturës së mjaftueshme në disa zona, jo të gjitha zonat ekonomike kanë të njëjtën nivel të zhvillimit të infrastrukturës.
Mundësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i sektorëve të rinj, ekziston mundësia për të zhvilluar sektorë të rinj të ekonomisë, si teknologjia e informacionit dhe komunikacionit (TIK), që mund të kontribuojnë në diversifikimin ekonomik. • Përmirësimi i Teknologjisë dhe Infrastrukturës, me investime të reja, ekziston potenciali për të përmirësuar teknologjinë dhe infrastrukturën, duke rritur kështu atraktivitetin e zonave ekonomike. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimet në Politikën Qeveritare dhe Legjislacionin: Ndryshimet e papritura në politikën qeveritare dhe legjislacionin mund të krijojnë pasiguri për investitorët dhe bizneset. • Konkurenca nga vendet fqinje, zonat ekonomike mund të përballen me konkurrencë nga zonat e ngjashme në vendet fqinje, të cilat mund të ofrojnë kushte më të favorshme. • Rritja e kostove të energjisë dhe lëndëve të para, rritja e kostove të energjisë dhe lëndëve të para mund të ndikojë negativisht në profitabilitetin e bizneseve të vendosura në këto zona.

Këto janë elementet kryesore të analizës SWOT për zonat ekonomike në bazë të të dhënave të mbledhura nga pyetësi. Rekomandimet e ndryshme që janë dhënë nga pjesëmarrësit, si

decentralizimi i menaxhimit dhe përmirësimi i kuadrit ligjor, janë thelbësore për të adresuar dobësitë dhe për të shfrytëzuar mundësitë.

17. Konkluzione

Bazuar në analizën e të dhënave, mund të konkludohet se zonat ekonomike në Kosovë ofrojnë një infrastrukturë të zhvilluar dhe pozicion strategjik, që i bën tërheqëse për investitorët, të mbështetura nga përkrahja qeveritare. Administrimi i këtyre zonave kryhet kryesisht nga komunat përkatëse, me përjashtim të parkut industrial në Drenas, i cili administrohet nga MINT dhe komuna e Drenasit. Megjithatë, disa nga sfidat kryesore përfshijnë procedurat komplekse administrative, mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe infrastrukturën e pamjaftueshme në disa zona. Përkundër këtyre sfidave, ekziston potencial i lartë për investime të huaja direkte dhe zhvillimin e sektorëve të rinj, të cilët mund të kontribuojnë në përmirësimin e teknologjisë dhe rritjen e infrastrukturës. Në anën tjetër, kërcënimet e mundshme përfshijnë ndryshimet e papritura në politikat qeveritare, konkurrencën nga vendet fqinje dhe rritjen e kostove të energjisë dhe lëndëve të para, të cilat kërkojnë vëmendje të vazhdueshme.

18. Rekomandime

Për të përmirësuar funksionimin dhe atraktivitetin e zonave ekonomike në Kosovë, rekomandohet thjeshtësimi i procedurave administrative për të tërhequr më shumë investitorë. Krijimi i një ndarjeje të qartë të llojeve të ndryshme të zonave dhe parqeve ekonomike, së bashku me përcaktimin e karakteristikave kryesore të tyre, do të ndihmonte në targetimin më të saktë të investitorëve. Lejimi i kompanive që të përdorin ndërtesat e ndërtuara në tokën e zonës si kolateral për kredi do të siguronte qasje më të lehtë në financim. Gjithashtu, investimi në arsim dhe trajnime profesionale do të rrisë kapacitetin e fuqisë punëtore të kualifikuar, ndërsa përmirësimi i infrastrukturës në zonat ku mungon do të rrisë atraktivitetin e tyre.

Një aspekt kyç është edhe zgjerimi i kriterëve për vlerësimin e aplikimeve për parcelat e tokës, duke u fokusuar më shumë në cilësinë e projekteve investuese dhe duke reflektuar llojet e ndryshme të zonave dhe parqeve. Sigurimi që studimet e fizibilitetit të kryhen nga ekspertë të pavarur dhe të përfshijnë një vlerësim të plotë të tregut dhe rrezikut është një tjetër masë që do të përmirësonte cilësinë e projekteve.

Për të nxitur investimet e huaja direkte, rekomandohet promovimi aktiv dhe ofrimi i incentivave, së bashku me lejimin e negociatave të drejtpërdrejta me investitorët strategjikë. Rishikimi i mundësisë për futjen e parqeve industriale të përcaktuara tërësisht ose pjesërisht për investitorët e huaj ose diasporën, përfshirë një menaxhim të veçantë për të siguruar një qasje jodiskriminuese, është gjithashtu i rëndësishëm. Në këtë kontekst, një kuadër ligjor dhe politik stabil do të rrisë besimin e investitorëve.

Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet qeverisë qendrore dhe komunave do të ndihmojë në administrimin më efektiv të zonave ekonomike, ndërsa inkurajimi i zhvillimit të sektorëve të rinj, si teknologjia e informacionit dhe komunikacionit, do të diversifikojë ekonominë dhe do të krijojë mundësi të reja për rritje ekonomike. Po ashtu, rekomandohet rishikimi dhe harmonizimi i tarifave të qirasë në zonat ekonomike, veçanërisht në Parkun e Biznesit në Drenas, për të siguruar konkurrencë të qëndrueshme dhe për të stimuluar investimet e mëtejshme.

Mundësitë për përmirësim të efektivitetit të zonave ekonomike në Kosovë

Në Kosovë, ekzistojnë shumë mundësi për të përmirësuar dhe maksimizuar përfitimet e Zonave Ekonomike. Për të arritur suksesin e plotë, duhet të plotësohen disa parakushte të rëndësishme. Performanca aktuale e Zonave Ekonomike në Kosovë tregon një potencial të madh për rritje dhe zhvillim. Për të realizuar këtë potencial, është e rëndësishme të adoptohet një qasje afatgjatë, pasi efektet e programeve të zonës shpesh shpalosen brenda pesë deri në dhjetë vjet.

Ekzistojnë katër dimensionet kryesore që duhet të adresohen për të përmirësuar efektivitetin e Zonave Ekonomike në Kosovë:

- **Fokusi strategjik:** Duhet një kuadër koherent strategjik që përcakton objektivat dhe prioritetet për grupet e synuara dhe llojet e zonave. Strategjia duhet të jetë në harmoni me ligjin për investime të qëndrueshme nr. 08/L-209.
- **Propozimi i vlerës:** zonat ekonomike duhet të ofrojnë kushte bindës për investitorët, duke përfshirë infrastrukturë dhe shërbime të orientuara drejt grupeve të synuara dhe duke lejuar përdorimin e ndërtesave si kolateral për kredi, e cila tanimë është e rregulluar me legjislacionin për parqe industriale dhe teknologjike.
- **Proceset dhe kriteret e përzgjedhjes:** Zonat e reja duhet të bazohen në studime të plota të fizibilitetit, respektivisht në UA r. 05/2024 për përmbajtjen e studimit të fizibilitetit për parqet industriale dhe teknologjike, duke përfshirë një vlerësim të shëndoshë të tregut dhe rrezikut.
- **Modeli institucional:** Zonat duhet të kenë një njësi menaxhuese që ofron shërbime të lidhura me infrastrukturën, zhvillimin e biznesit dhe shërbimet administrative, dhe të përfshijë sektorin privat në zhvillimin dhe funksionimin e tyre, duke u bazuar në UA Nr. 07/2024 për përcaktimin e mënyrës së administrimit dhe menaxhimit të parqeve industriale dhe teknologjike.

Kapitulli II

Krijimi i Parqeve Industriale dhe Teknologjike të reja të mundshme në Kosovë

1. Hyrje

Duke marrë parasysh që ende mbetet për t'u dëshiruar në përmirësimin e shumë aspekteve ekonomike, siç është punësimi, ndryshimi strukturor në aspektet ekonomike të cilat ndërlidhen me bilancin tregtar, nxitja më e përsheptuar e investimeve, Qeveria e Kosovës përmes politikave tatimore në kombinim me politika të tjera financiare, të mbështesë nxitjen e mëtejme të zhvillimit ekonomik të vendit. Gjithnjë duke pasur parasysh zhvillimin e parqeve industriale dhe teknologjike, këtë për arsyeje se pas analizave të bëra, parqet ofrojnë një mundësi të mirë në:

- Krijimin e një ambienti të favorshëm për investime të reja, sidomos bizneseve prodhuese
- Përmirësimin potencial të bilancit tregtar
- Përkrahjen e bizneseve, e sidomos në zonat e pazhvilluara.

Andaj lehtësira tatimore vetëm për parqet industriale teknologjike do të ishin të mirëseardhura, sepse aktualisht për politikën fiskale të gjitha aktivitetet afariste që zhvillohen në Kosovë i sheh si një zonë të vetme ekonomike, andaj diferencimet tatimore për parqet industriale dhe teknologjike do të paraqiten si një zgjedhje e problemit në zhvillimin ekonomik dhe kjo do të ndikonte pozitivisht në sektorë të caktuar të ekonomisë, në këtë rast më atë të prodhimit.

2. Qëllimi

Qëllimi i studimit është identifikimi i gjendjes aktuale të komunave më qëllim të potencial për zhvillim të zonave ekonomike, si dhe ndikimit i tyre i mundshëm në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Nxjerrja e rezultateve nga ky studim, ku se bashku me rezultatet tjera të mbledhura nga të dhënat primare dhe sekondare do të na mundësojnë të identifikojmë nevojën për:

- ✓ Krijimin e Parqeve industriale dhe teknologjike,
- ✓ Nxitjen dhe inkurajimin e institucioneve lokale dhe qendrore për krijimin e Parqeve industriale dhe teknologjike,
- ✓ Prezantimin e disa përvojave të suksesshme të vendeve të tjera sa i përket zhvillimit të Parqeve industriale dhe teknologjike,

- ✓ Ndikimin e Parqeve industriale dhe teknologjike në hapjen e vendeve të reja të punës, në krijimin e të ardhurave, tërheqjen e teknologjive të përparuara, përqendrimin e bizneseve në një vend të caktuar, zgjerimin e bashkëpunimit mes bizneseve, rritjen e konkurrencës, etj.

Gjatë hulumtimit studimor është përdorur literaturë profesionale dhe shkencore, përfshirë legjislacionin në Kosovë, praktikën e vendeve të rajonit dhe në nivel botëror. Janë përdorur publikime të ndryshme me qëllim që të analizohen efektet e Parqeve industriale dhe teknologjike në zhvillimin e sektorit privat në Kosovë, respektivisht sfidave aktuale dhe problemet që kanë bizneset jashtë zonave dhe brenda zonave.

Materiali i cili do të përdoret do të mbështetet kryesisht në të dhënat primare dhe sekondare të grumbulluara nga burime të ndryshme, përfshirë studime të bëra nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, hulumtime të tjera që janë bërë në nivel të vendit, anketime me komunitet e Kosovës, anketime me bizneset, etj.

3. Përshkrimi i gjendjes aktuale të shtatë regjioneve përfshirë komunitet që kanë potencial për themelimin të Parqeve Industriale dhe Teknologjike

Zhvillimi ekonomik dhe rritja e qëndrueshme ekonomike e Kosovës janë synimet dhe prioritetet kryesore strategjike të secilit vend, poashtu përfshirë edhe Kosovën. Zhvillimi i sektorit privat, respektivisht i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë është faktori kyç për zhvillimin ekonomik të vendit.

Zhvillimi ekonomik i Kosovës ka kaluar nëpër faza të vështira të ndryshme të zhvillimit. Në periudhën e pas luftës së dytë botërore filloi në kushte dhe rrethana të një sistemi të socializmit centralist që u aplikua në ish Federatën Jugosllave. Në atë periudhë Kosova ishte një vend tipik agrar pa industri të zhvilluar ku bujqësia merrte pjesë me 70% e të ardhurave që krijoheshin, kurse vetëm 30% prodhimet industriale. Struktura e ekonomisë ishte e pa zhvilluar dhe e përfaqësuar me një numër të vogël të degëve industriale që kryesisht përfaqësoheshin nga xehet dhe përpunimi i metaleve me ngjyra, përpunimi i drurit si dhe prodhimi i thëngjillit.

Rritje të theksuar në themelimit të NVM-ve shënohet në vitet 1990-1993. Themelimi i këtyre ndërmarrjeve nuk është rezultat i krijimit të kushteve, por i viteve kur njerëzit e përzënë nga puna për të mbijetuar hapën biznesin e tyre si alternative për punësim të vetin dhe të familjes. Kjo periudhë zgjati deri në vitin 1999, ku edhe ato pak biznese të vogla, që lirisht mund t'i quajmë familjare, pothuajse u shkatërruan nga lufta.

Pavarësisht kësaj, Kosova është ende në fazën e tranzicionit ku ndërmarrësia dhe krijimi i NVM-ve pritet të luajë rol të rëndësishëm në rrugën drejt një ekonomie moderne të tregut të lirë dhe drejt zhvillimit dhe rritjes ekonomike.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) kanë një rol ekonomik dhe social shumë të rëndësishëm, për shkak të kontributit të tyre në funksionimin e rrjetit ekonomik dhe në krijimin e vendeve të punës. Këto kontribute janë shumë të vlershme në kushtet e krizës dhe të rritjes së papunësisë. Zhvillimi i NVM-ve mund të kontribuojë në përballimin e sfidave të shumta të lidhura me zhvillimin ekonomik, efektet e pabarazisë, nivelin e lartë të papunësisë, rritjen demografike dhe nevojën për ndryshime strukturale.

Zhvillimi i NVM-ve ofron shumë mundësi punësimi, që mund të ndihmojnë në zvogëlimin e nivelit të papunësisë dhe në përballimin e sfidave demografike të këtyre popullatave, të cilat janë në rritje të shpejtë. Përveç kësaj, zhvillimi i sektorit të NVM-ve mund të kontribuojë në përforsimin e konkurrueshmërisë dhe të prodhueshmërisë, duke nxitur njëkohësisht rritjen e të ardhurave të vendit. Ky zhvillim do të promovojë edhe transformimin struktural të sektorit të NVM, për arsye të lidhjes së tij me inovacionet dhe zhvillimet teknologjike. Këto zhvillime pozitive do të përmirësojnë mundësitë ekonomike dhe politike, duke transformuar projektimet demografike dekurajuese, të cilat thellojnë varfërinë dhe paqëndrueshmërinë, në forca që mund të shkaktojnë ndryshime pozitive.

Zhvillimi i ndërmarrjeve të reja sjellë njerëz të rinj në fuqinë punëtore, shton tatimpagues të rinj, produkte dhe shërbime në tregjet vendëse, rajonale dhe globale.

“NVM-të janë burim punësimi, konkurrence, dinamizmi ekonomik dhe novacioni; ato stimulojnë shpirtin ndërmarrës dhe përhapjen e aftësive. Për shkak se gëzojnë prani gjeografike më të gjerë sesa kompanitë e mëdha, NVM-të kontribuojnë edhe në shpërndarjen më të mirë të të ardhurave”³.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë shumë fleksibile ndaj ndryshimeve inovative dhe përshtatshmërisë se tregut. Andaj duke ditur rëndësinë e NVM-ve në krijimin e vendeve të punës, zbutjen e pavarësisë, rritjes ekonomike dhe novacionit, qeveritë duhet të marrin përgjegjësi për stimulimin e zhvillimit të NVM-ve.

Zhvillimi i NVM-ve është forca lëvizëse e zhvillimit ekonomik, ndërmarrësit prezantojnë ide të reja në treg, që janë bartës të proceseve të zhvillimit ekonomik. Vetëm dëshira për të pasur sukses nuk mjafton! dëshira dhe puna e palodhshme mund ta bëjnë të mundshëm suksesin nëse ideja është e mirë. Gjithashtu edhe ideja e shkëlqyer e biznesit kërkon punë të mundimshme, prandaj duhet pasur parasysh aftësitë, shkathtësitë dhe përvoja e punës në mënyre që biznesi t’i përshtatet më së miri këtyre attributeve, duke përfshirë edhe faktorët e rrezikut dhe sjelljet që ndikojnë në ndërmarrësi. Ndërmarrjet, me theks të veçantë NVM-të, janë një ndër faktorët e rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe për punësim.

³ Burggraaf W., Floren R., Kunst J. The Entrepreneur & the Entrepreneurship Cycle, Netherlands, Van Gorcum, 2008 fq. 28-29.

Në aspektin global, NVM-të edhe pse kanë mundësi të njëjta me ndërmarrjet e mëdha në përfshirjen e tyre në të gjitha sektorët ekonomik por përsëri ndërmarrjet e vogla kanë më tepër interes për disa sektor të ekonomisë e veçanërisht për sektorin e tregtisë dhe të shërbimeve në krahasim me prodhimtarinë. Gjithashtu, NVM-të janë faktorë zhvillues dinamik nga se shpejt bëjnë hapjen e vendeve të reja të punës, rrisin ofertën e mallrave dhe të shërbimeve, zhvillojnë kreativitetin, rrisin konkurrencën në ekonomi dhe forcimin e aftësisë konkurruese. Andaj këto ndërmarrje, rrisin dinamizmin e tregut dhe në këtë mënyrë ndihmojnë të mbajnë ritmin e përshtatjes ndaj kushteve të reja ekonomike dhe politike. Krijimi i një kulture të shëndoshë për zhvillimin e NVM-ve janë krijimi i hapësirave të punës me krijimin e Parqeve Industriale dhe teknologjike, që njëherit është një faktor i rëndësishëm për tërheqjen e ndërmarrjeve të reja me theks te veçante ndërmarrjet prodhuese.

Klima e favorshme e biznesit është thelbësore për tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD) dhe për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM). Stabiliteti makroekonomik dhe rritja ekonomike kanë një rol të rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit ekonomik. Për investuesit e kompanive, treguesit më të rëndësishëm të stabilitetit makroekonomik janë ata që ndikojnë drejtpërdrejt në bilancet e tyre si për shembull rritja e PBB-së, inflacioni, rritja e popullsisë dhe niveli i edukimit (arsimimit) etj., gjithashtu kursi i interesave është shumë i rëndësishëm për NVM-të. Prandaj hapja e një vendi (shteti) ndaj tregtisë me vendet e jashtme, investuesit dhe kapaciteteve njerëzore të huaj (jashtëm), do të ndikonte në suksesin dhe në nxitjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Stabiliteti legjislativ është një nga elementët kyç për një mjedis politik që mbështet klimën e fuqishme të biznesit dhe investimeve. Ligjet, që ndryshohen vazhdimisht, ndikojnë negativisht në aftësinë e investuesve për të parashikuar fitimet. Për më tepër, kosto shtesë për një investues janë edhe modifikimi i praktikave të biznesit si financa dhe auditimi, outputet mjedisore dhe administrimi i kapaciteteve apo burimeve njerëzore të punës. Gjithashtu, edhe kur kushtet janë të favorshme në një moment të caktuar, një mjedis i paqëndrueshëm legjislativ mund t'u japë investuesve përshtypjen se është i lartë rreziku i thellimit të kushteve të pafavorshme, që mund t'i bindin ata, që të heqin dorë nga investimi.

Ndërmarrjet ndërnacionale parapëlqejnë të investojnë në vende me klimë të shëndetshme biznesi ku kostot, vonesat dhe risku janë të minimizuar. Përveç kësaj, NVM-të janë më të pritura të lulëzojnë në një klimë ku nuk rëndohen së tepërmi me taksa dhe rregullime, procedura etj.

4. Sektorët e bizneseve më të zhvilluara në regjione

Tabela 15. Ndërmarrjet e regjistruara sipas Kodi/Seksionet e aktiviteteve ekonomike, komuna, viti dhe periudha

2023	Deçan	Gjakovë	Glllogoc	Gjilan	Dragash	Istog	Kaçanik	Klinë	Fushë Kosovë	Kamenicë	Mitrovicë	Leposaviq	Lipjan
A Bujqësi, pylltari dhe peshkatar	7	9	4	17	1	23	0	19	4	11	4	3	7
B Xehetari dhe gurëthyes	0	1	0	2	0	0	0	2	0	0	0	0	1
C Prodhim	17	58	28	68	8	13	22	17	48	18	37	0	34
D Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	3	2	0	3	0	2	0	0	1	0	9	0	2
E Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	0	1	2	1	0	0	1	1	2	0	2	0	3
F Ndërtimtari	14	66	51	51	6	26	33	21	51	7	37	1	44
G Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	21	112	51	163	7	27	34	39	133	23	115	10	89
H Transport dhe ruajtje	2	4	4	23	0	4	5	5	19	10	9	0	8
I Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	10	62	17	79	9	10	13	6	32	7	34	1	24
J Informacion dhe komunikim	1	18	4	22	1	2	2	2	34	2	27	0	9
K Aktivitete financiare dhe sigurimit	0	2	1	5	0	0	1	2	5	2	0	0	2
L Aktivitete të patundshmërisë	1	1	2	6	0	0	3	1	9	0	3	0	3
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	5	19	21	69	4	9	10	9	50	8	34	1	25
N Aktivitete administrative dhe mbështetëse	2	24	14	51	1	8	16	7	42	8	20	0	33

O Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	1
P Arsimit	1	4	3	8	0	6	2	4	7	2	6	0	7
Q Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	3	9	4	21	2	3	3	5	18	1	13	0	6
R Art, zbavitje dhe rekreacion	3	16	2	10	4	1	3	1	15	1	15	0	4
S Aktivitete të shërbimeve tjera	4	74	13	57	5	10	9	12	41	6	28	0	18
Gjithsej	94	482	221	656	48	144	157	153	512	106	393	16	320

2023	Novobërdë	Obiliq	Rahovec	Pejë	Podujevë	Prishtinë	Prizren	Skenderaj	Shtime	Shtërpce	Suharekë	Ferizaj	Viti
A Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	1	7	13	23	14	41	19	13	5	2	16	29	7
B Xehetari dhe gurëthyes	1	3	1	2	0	3	2	1	0	0	2	2	0
C Prodhim	3	21	27	55	20	188	107	17	22	3	47	163	21
D Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	1	0	0	5	1	57	2	1	0	0	0	6	2
E Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	0	1	0	2	1	12	0	0	1	0	1	0	0
F Ndërtimtari	0	14	25	51	37	216	78	33	17	1	42	95	35
G Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	6	35	35	134	87	752	244	26	30	7	47	282	43
H Transport dhe ruajtje	0	4	6	8	13	57	19	3	6	1	4	26	6
I Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	3	7	18	66	29	275	108	7	10	8	17	101	22

J Informacion dhe komunikim	1	7	3	17	13	384	38	4	3	1	8	40	8
K Aktivitete financiare dhe sigurimit	0	3	3	0	3	52	5	2	0	0	2	9	2
L Aktivitete të patundshmërisë	0	2	0	14	3	108	16	0	0	2	3	11	2
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	2	6	9	50	17	615	75	11	6	3	19	94	4
N Aktivitete administrative dhe mbështetëse	0	7	10	49	26	252	58	10	4	3	18	65	14
O Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	0	0	0	1	0	8	2	0	0	0	0	0	0
P Arsim	0	1	0	8	3	64	7	3	2	0	4	6	3
Q Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	0	3	0	20	2	96	35	4	2	0	4	22	6
R Art, zbavitje dhe rekreacion	0	2	8	7	6	65	25	2	1	1	3	17	2
S Aktivitete të shërbimeve tjera	0	7	13	31	24	169	72	10	6	0	8	74	11
Gjithsej	18	130	171	543	299	3414	912	147	115	32	245	1042	188

2023	Vushtrri	Zubin Potok	Zveqan	Malishevë	Juniku	Mamushë	Hani i Elezit	Graçanica	Ranillug	Partesh	Klllokot	Mitrovica Veriore
A Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	12	3	2	5	6	52	0	15	0	0	1	0
B Xehetari dhe gurëthyes	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0
C Prodhim	46	2	1	16	2	12	2	16	1	1	1	1
D Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	7	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0

E Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	2	0	1	1	1	0	0	1	0	0	0	0
F Ndërtimtari	49	1	0	53	0	2	4	7	0	0	0	0
G Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	79	2	3	41	0	7	10	52	1	1	4	13
H Transport dhe ruajtje	11	0	0	7	0	0	3	7	0	1	0	1
I Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	30	0	1	11	0	1	8	27	3	0	2	3
J Informacion dhe komunikim	24	0	0	3	0	1	0	2	0	0	0	3
K Aktivitete financiare dhe sigurimit	2	0	0	2	0	0	1	0	0	0	0	0
L Aktivitete të patundshmërisë	0	0	0	0	0	0	0	7	0	0	0	0
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	23	0	0	7	0	0	0	5	0	0	0	1
N Aktivitete administrative dhe mbështetëse	18	0	0	9	3	0	1	7	0	0	1	0
O Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
P Arsim	4	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0
Q Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	13	0	0	1	0	0	0	5	0	0	0	0
R Art, zbavitje dhe rekreacion	5	0	0	0	0	0	0	1	2	0	0	0
S Aktivitete të shërbimeve tjera	21	0	0	15	1	2	2	4	0	1	0	3
Gjithsej	349	8	8	175	13	77	33	156	7	4	9	25

Me gjerësisht linku i ASK: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/80d67107-c129-49dc-b74b-3ac65381e34c.pdf>

5. Identifikimi i mundësive për tërheqjen e investimeve të huaja dhe vendore

Për të rritur promovimin e mundësive të investimeve në Kosovë, sugjerohet të zhvillohet një strategji e integruar që thekson përparësitë e vendit si një destinacion atraktiv për investitorët. Kjo përfshin krijimin e fushatave të marketingut që shpalosin pozitën strategjike gjeografike të Kosovës, fuqinë punëtore të re dhe energjike, dhe kostot e ulëta të operimit, duke përdorur platforma digjitale dhe evente ndërkombëtare për të arritur investitorët e synuar.

Gjithashtu, duhet të theksohet mbështetja e qeverisë përmes lehtësirave fiskale dhe infrastrukturës së përmirësuar, si dhe mundësitë e zhvillimit të sektorëve kyç të ekonomisë që kanë potencial të lartë për rritje.

Përveç kësaj, është e rëndësishme të organizohen takime të drejtpërdrejta B2B (business-to-business) me investitorë potencialë, pjesëmarrje aktive në panairë të biznesit, konferenca ndërkombëtare, dhe forume të ndryshme investimesh, ku përfaqësuesit e institucioneve dhe sektorit privat mund të ndërtojnë lidhje dhe të ofrojnë informacione të detajuara mbi mundësitë e investimit. Për më tepër, duhet të theksohet mbështetja e qeverisë përmes politikave të favorshme fiskale, subvencioneve dhe infrastrukturës së përmirësuar, si dhe mundësitë e zhvillimit të sektorëve kryesorë të ekonomisë që kanë potencial të lartë për rritje, si teknologjia e informacionit, energjia e rinovueshme, bujqësia dhe turizmi. Kombinimi i këtyre masave do të krijojë një mjedis tërheqës për investitorët e huaj dhe vendas, duke stimuluar zhvillimin ekonomik afatgjatë.

6. Identifikimi i mundësive të bashkëpunimit ndërmjet Parqeve Industriale dhe Teknologjike dhe palëve të interesit


Tabela 16. Përfitimet për zhvillimin e komunës apo regjionit

Çfarë përfitimesh mendoni se do të sjellin këto parqe për zhvillimin e komunës tuaj apo të regjionit?	Përgjigjet e komunave	Përqindja
Zhvillim Ekonomik	14	40%
Punësim	14	40%
Investime nga te huaj/ndërkombëtar	4	11.43%
Përfitime të tjera në të mirën e komunës	3	8.57%
Total	35	100%

Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Tek përfitimet që mendojnë se do të sjellin këto parqe për zhvillimin e komunës së tyre prej tyre 14 ose 40% kanë deklaruar se do të sjellin zhvillim ekonomik, 14 apo 40% punësim dhe investime të huaja ndërkombëtare kemi 4 apo rreth 11% dhe të tjerët mendojnë se do të kenë përfitime të tjera në të mirën e komunës.

Figura 5. Lloji i pronës



Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Bazuar në të dhënat e paraqitura në figurë, kemi një ndarje të qartë të llojit të pronës së disponueshme për krijimin e Parqeve Industriale dhe Teknologjike në komunat e intervistuar.

Komunat që kanë prona komunale për krijimin e këtyre parqeve përfshijnë Klinën, Obiliqin, Skenderaj, Deçanin, Dragashin, Kaçanikun, Ferizajn, Graçanicën, Klllokotin, Novobërdën, Ranillugun, Malishevën dhe Prishtinën. Prona komunale përbën 65% të totalit të pronave të identifikuar, duke qenë kategoria më e madhe dhe më e disponueshme për këtë qëllim.

Përveç pronave komunale, Skenderaj dhe Klina kanë edhe pronë shoqërore që mund të përdoret për krijimin e parqeve industriale dhe teknologjike.

Kaçaniku dhe Ranilluga, përveç pronës komunale, kanë edhe prona private të disponueshme për ndërtimin e parqeve.

Ndërkaq, Prizreni, Hani i Elezit dhe Gjlani kanë prona publike të cilat përbëjnë 15% të totalit të pronave të identifikuar. Ky lloj prone gjithashtu ofron mundësi të mira për krijimin e parqeve industriale dhe teknologjike.

7. Identifikimi i fuqisë punëtore sipas regjioneve

Tabela 17. Klasifikimi I tregut të punës për popullsinë e Kosovës, 2023

Kategoria	Meshkuj	Femra	Total
Popullsia e përgjithshme e vlerësuar (për vitin 2023)	875,784	886,436	1,762,220
Fëmijë (mosha 0-14)	201,136	187,095	388,231
Të moshuar (mosha 65+)	98,359	103,867	202,226
Popullsia në moshë pune (15-64)	576,289	595,474	1,171,763
Fuqia Punëtore (persona aktivë)	333,019	144,331	477,350
Persona joaktivë	243,270	451,143	694,413
Fuqia Punëtore tek të rinjtë (15-24 vjeç)	41,974	21,691	63,665
Të punësuar	307,509	117,990	425,499
Të papunësuar	25,510	26,341	51,851
Të rinjë të punësuar (15-24 vjeç)	35,923	16,746	52,669
Të rinjë të papunë (15-24 vjeç)	6,051	4,945	10,996

Burimi ASK: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/d8b6019c-eccf-419f-a5b0-9fb7df247ce3.pdf>

Tabela 18. Fuqia punëtore dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë dhe grupmoshës

Kosovë	Meshkuj	Femra	Total
Fuqia punëtore (në mijëra)			
15-19	6608	2388	8996
20-24	35366	19302	54668
25-29	43311	22315	65626
30-34	41018	21076	62094
35-39	42203	16294	58497
40-44	37212	18447	55659
45-49	38650	16527	55177
50-54	35686	13306	48992
55-59	30625	8670	39295
60-64	22340	6006	28346
Total 15-64	333019	144331	477350

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (%)			
15-19	9.8	3.6	6.7
20-24	44.4	26	35.5
25-29	67.9	36.7	52.7
30-34	70.6	37.0	54.0
35-39	79.1	30.4	54.70
40-44	72	31.9	50.8
45-49	69.7	25.8	46.2
50-54	68.7	21.6	43.2
55-59	60.5	16	37.5
60-64	50.3	13.1	31.4
Total 15-64	57.8	24.2	40.7

Burimi ASK: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/d8b6019c-eccf-419f-a5b0-9fb7df247ce3.pdf>

Tabela 19. Identifikimi i fuqisë punëtore sipas regjioneve

Rajoni	Popullsia në moshë pune (15-64 vjeç)	Fuqia punëtore (persona aktivë)	Të punësuar	Të papunësuar	Persona joaktivë
Prishtina	374,652	165,124	146,157	18,967	209,528
Mitrovica	171,075	67,510	58,299	9,211	103,565
Peja	148,954	58,702	52,432	6,270	90,252
Prizreni	236,851	87,935	78,234	9,701	148,916
Ferizaj	173,449	65,384	58,245	7,139	108,065
Gjilani	155,469	57,844	51,039	6,805	97,625
Gjakova	122,726	47,760	41,634	6,126	74,966

Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Këto të dhëna përshkruajnë shpërndarjen e fuqisë punëtore në regjione të ndryshme të Kosovës, duke përfshirë numrin e personave të punësuar dhe të papunësuar, si dhe ata që janë joaktivë.

Tabela 20. Infrastruktura aktuale

Çfarë infrastrukture ekziston aktualisht në komuna për zhvillimin e parqeve industriale dhe teknologjike?	Përgjigjet e komunave	Përqindja
Infrastrukturë funksionale (ka rrugë, energji, ujë, kanalizime)	8	47.06%
Infrastrukturë jo funksionale (nuk ka rrugë, energji, ujë, kanalizime)	9	52.94%
Total	17	100%

Nga 17 komunat të cilat kanë potencial për krijimin e Parqeve Industriale dhe Teknologjike gjithashtu janë pyetur për infrastrukturën aktuale dhe prej tyre 8 komunat të cilat kanë infrastrukturë funksionale që kanë rrugë, energji, ujë dhe kanalizime, ato janë: Klina, Prizreni, Skenderaj, Deçan, Graçanica, Klllokoti, Malisheva dhe Prishtina.

Kurse 9 komunat të cilat nuk posedojnë infrastrukturë funksionale janë: Obiliq, Dragash, Kaçanik, Ferizaj, Junik, Hani i Elezit, Gjilan, Novobërdë dhe Ranillug.

Tabela 21. Vlerat e përafërta për ndërtimin e parqeve

Vlera e përafërt që mund të kushtoj për të ndërtuar parkun?	Përgjigjet e komunave	Përqindja
100 mijë deri në 1 Milion Euro	3	17.65%
1. 5 Milion deri në 3 Milion Euro	10	58.82%
3.5 Milion deri në 5 Milion Euro	4	23.53%
Total	17	100%

Vlera e përafërt që mund të kushtojë për të ndërtuar Parkun Industrial Teknologjik sipas përgjigjeve të marra nga 17 komunat që kanë potencial për themelin të këtyre parqeve janë paraqitur në tabelën e mësipërme.

Nga 17 komuna të intervistuar 3 prej tyre apo 17.65% kanë deklaruar se vlera e përafërt mund të jetë 100 mijë euro deri në 1 milion euro, 19 prej tyre kanë shprehur se 1.5 milion euro deri në 3 milion euro, dhe pjesa tjetër kanë shprehur se vlera e përafërt mund të jetë 3.5 milion euro deri në 5 milion euro.

Figura 6. Sektorët e bizneseve më të përshtatshme për tu vendosur në parqet Industriale ose Teknologjike




Figura 6 paraqet përqindjen e sektorëve të biznesit që konsiderohen më të përshtatshëm për t'u vendosur në parqet industriale dhe teknologjike në komunën me potenciale për të krijuar parqe industriale dhe teknologjike:

- **Prodhimi dhe përpunimi i mallrave (39.02%):** Ky sektor ka përqindjen më të lartë, duke treguar se është prioritet për zhvillimin ekonomik të komunës. Ky sektor ofron mundësi të mëdha për punësim dhe rritje ekonomike.
- **Teknologjia e informacionit (IT) (29.27%):** Me një përqindje të konsiderueshme, ky sektor pasqyron një interes të madh për inovacion dhe zhvillim teknologjik. Investimi në IT mund të çojë në krijimin e startupeve dhe përmirësimin e proceseve të biznesit.
- **Energjia e rinovueshme (14.63%):** Ky sektor tregon një interes për qëndrueshmëri dhe përdorim të burimeve të ripërtëritshme, duke ndihmuar në uljen e ndikimit mjedisor dhe rritjen e efikasitetit energjetik.
- **Agro-biznesi (12.20%):** Ky sektor është i rëndësishëm për zhvillimin rural dhe sigurinë ushqimore, duke ofruar mundësi për inovacion në bujqësi dhe përpunim të produkteve ushqimore.
- **Të tjera (4.88%):** Një përqindje e vogël tregon diversitetin e interesave dhe potencialin për zhvillim në sektorë të ndryshëm.

Figura 7. Mbështetja financiare për bizneset



Nga 17 komunat e intervistuar për mbështetjen financiare ose lehtësirat që ofrohen për bizneset që vendosen në këto parqe, të dhënat tregojnë se:

- **Lehtësira në taksa komunale:** 64.71% e komunave ofrojnë lehtësira në taksa komunale për të inkurajuar bizneset që të vendosen në parqet industriale dhe teknologjike.
- **Mbështetje financiare për infrastrukturë:** 35.29% e komunave ofrojnë mbështetje financiare për zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme për këto biznese.

Tabela 22. Strategjitë për tërheqjen e investimeve

Cilat strategji do të përdorni për tërheqjen e investimeve në zonat e mundshme për zhvillimin e parqeve industriale dhe teknologjike?	Përgjigjet e komunave	Përqindja
Promovimi i zonave përmes panairove dhe konferencave ndërkombëtare	16	38.10%
Bashkëpunimi me agjencitë qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare	8	19.05%
Ofrimi i paketave të iniciativave për investitorët	6	14.29%
Krijimi i një mjedisi të favorshëm biznesi me infrastrukturë të përmirësuar dhe shërbime mbështetëse	12	28.57%
Total	42	100%

Nga të dhënat e mbledhura në nivel komunal për tërheqjen e investimeve në parqet industriale dhe teknologjike, kemi katër kategori kryesore:


1. **Promovimi përmes panairove dhe konferencave ndërkombëtare (38.10%):** Kjo strategji ka përqindjen më të lartë, duke treguar përkushtimin për promovimin e zonave të zhvillimit përmes aktiviteteve ndërkombëtare.
2. **Krijimi i një mjedisi të favorshëm biznesi (28.57%):** Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve mbështetëse është thelbësor për tërheqjen e investitorëve dhe krijimin e kushteve optimale për zhvillim.
3. **Bashkëpunimi me agjencitë qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare (19.05%):** Ky bashkëpunim ofron mbështetje teknike, financiare dhe promovuese, duke ndihmuar në adresimin e sfidave dhe përsheptimin e zhvillimit.
4. **Ofrimi i paketave të iniciativave për investitorët (14.29%):** Stimuj financiarë dhe lehtësira tatimore janë pjesë e paketave që inkurajojnë investimet në këto zona.

5. Hulumtimi nga takimet me përfaqësuesit e komunave

Nga 29 komunat e intervistuar për potencialin e tyre për krijimin e Parqeve Industriale dhe Teknologjike prej tyre 17 komunat që kanë potencial për krijimin e Parqeve Industriale dhe Teknologjike përfshijnë: Klinën, Prizrenin, Obiliqin, Skenderajn, Deçanin, Dragashin, Kaçanikun, Ferizajn, Junikun, Hanin e Elezit, Gjilanin, Graçanicën, Klokotin, Novobërdën, Ranillugun, Malishevën dhe Prishtinën.

Disa nga arsyet se pse komunat kanë potencial ekonomik të lartë janë se kanë resurse natyrore të pasura, pozita gjeografike strategjike, dhe infrastrukturë të mirë. Për më tepër, ato mund të ofrojnë atraksione turistike, dhe një forcë punëtore të kualifikuar. Inovacioni dhe përdorimi i teknologjisë gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e mundësive ekonomike të një komune.

Figura 8. Potenciali i komunave për krijimin e Parqeve Industriale dhe Teknologjike




Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Sipas të dhënave nga hulumtimi kuptojmë se komunat të cilat nuk kanë potencial për krijimin e Parqeve Industriale dhe Teknologjike janë 12: Peja, Gjakova, Mamusha, Fushë Kosova, Istogu, Kamenica, Parteshi, Zveçani, Shtërpca, Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Mitrovica Veriore.

Komunat që nuk kanë potencial për krijimin e Parqeve Industriale dhe Teknologjike shpesh përballen me disa sfida si mungesa e buxhetit dhe hapësirave (pronave) të mjaftueshme për krijimin të parqeve industriale. Së bashku me këto, arsye të tjera përfshijnë mungesën e infrastrukturës të zhvilluar, ngarkesën e lartë demografike, pamundësinë për të tërhequr investime, mungesën e burimeve njerëzore të kualifikuara, si dhe ndikime ambientale që kufizojnë përdorimin e tokës. Këto faktorë e bëjnë të vështirë zhvillimin e parqeve industriale dhe teknologjike në këto komuna.

Figura 9. Toka e disponueshme



Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Nga 17 komunat të cilat kanë potencial për krijimin e Parqeve industriale dhe Teknologjike, komunat që kanë më pak se 10 hektarë të disponueshëm për krijimin e Parqeve Industriale dhe Teknologjike janë: Juniku, Hani i Elezit, Kllokoti, Novoherdë dhe Ranillug.

Komunat që kanë 11-50 hektarë tokë që janë të disponueshme për këtë qëllim janë Obiliq, Deçan, Dragash, Kaçanik, Ferizaj, Graçanice, Malisheva dhe Prishtina. 51-100 hektarë të disponueshëm i kanë Prizreni dhe Skenderaj, kurse më shumë se 100 hektarë të disponueshëm i kanë Klina dhe Gjilani.

8. Hulumtimi nga intervistat e realizuara me biznese potenciale për tu vendosur në parqet Industriale dhe Teknologjike


Pjesa e mëposhtme e këtij studimi, përmban të dhënat nga intervistat e realizuara me total 50 biznese potenciale për tu vendosur në parqet Industriale dhe Teknologjike në komunat Prishtinë, Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjiilan, Kamenicë, Lipjan, Malishevë, Pejë, Prizren, Rahovec dhe Viti.

Këto intervista janë realizuar duke përdorur pyetësorin që ka qenë i përbërë nga pyetje demografike të dhëna për biznesin si dhe pyetje të tjera të cilat kanë pas për qëllim të nxjerrin informata të hollësishme lidhur arsyet kryesore që i bëjnë të interesuar për tu vendosur në parqet industriale lidhur me sektorin e biznesit, krijimi i vendeve të punës etj. Tutje në këtë studim janë paraqitur të dhëna nga pyetësi i realizuar.

Sektorët e bizneseve, vlerësimi i sektorëve aktual dhe potencial të investimeve në kuadër të parqeve industriale

Ne kemi kryer një hulumtim për identifikimin e bizneseve potenciale për t'u vendosur në parqet industriale dhe teknologjike. Në total, janë intervistuar 50 biznese që kanë shprehur interes për t'u vendosur në këto parqe. Pikat kryesore që i bëjnë të interesuar këto biznese për krijimin e një parku industrial përfshijnë: qasjen në infrastrukturë të përmirësuar (rrymë, rrugë, ujë, kanalizim, rrethojë), lehtësirat tatimore, mbështetjen financiare ose lehtësirat për biznese, aksesin më të mirë tek furnitorët dhe tregjet, si dhe mungesën e hapësirës aktuale që posedojnë këto biznese.

Figura 10. Ndikimi i krijimit të parkut industrial tek bizneset




Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Nga të dhënat e mbledhura, rezulton se krijimi i parkut industrial dhe teknologjik në komunën tuaj do të kishte një ndikim të rëndësishëm në rritjen e eksportit të produkteve të prodhuara nga bizneset. Konkretisht, 90% e të anketuarve (45 nga 50) besojnë se do të kishte një ndikim pozitiv në eksport, ndërsa vetëm 10% (5 nga 50) nuk e shohin këtë si një mundësi.

Tabela 23. Sektori i bizneseve

Çfarë sektori është biznesi juaj?	Prodhimi dhe përpunimi i mallrave	Tregti dhe Shërbime	Teknologjia Informative (IT)	Energjia e rinovueshme	Total	Përqindja
Prishtinë	6	7	1	1	15	30%
Dragash	2	0	0	0	2	4%
Ferizaj	8	0	0	0	8	16%
Fushë Kosovë	3	0	0	0	3	6%
Gjakovë	1	0	0	0	1	2%
Gjilan	6	0	0	0	6	12%
Kamenica	1	2	0	0	3	6%
Lipjan	1	0	0	0	1	2%
Malishevë	2	0	0	0	2	4%
Pejë	2	0	0	0	2	4%
Prizren	4	1	0	0	5	10%
Rahovec	1	0	0	0	1	2%
Viti	0	1	0	0	1	2%
Total	37	11	1	1	50	100%

Figura 11. Sektori i bizneseve potenciale për tu vendosur në Parqet Industriale dhe Teknologjike



Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Nga të dhënat e mbledhura, bizneset janë të përqendruara kryesisht në sektorin e prodhimit dhe përpunimit të mallrave, që përbën 74% të totalit (37 nga 50). Sektori i tregtisë dhe shërbimeve përfaqëson 22% (11 nga 50), ndërsa sektori i teknologjisë informative (IT) dhe energjisë së rinovueshme përbëjnë secili nga 2% (1 nga 50). Kjo përbërje sektoriale tregon një dominim të industrisë prodhuese, veçanërisht në komunat si Ferizaj dhe Prishtinë, duke nënvizuar rëndësinë e zhvillimit të Parqeve Industriale dhe Teknologjike për mbështetjen e këtij sektori kyç për ekonominë.

Tabela 24. Kërkesat për sipërfaqen e tokës

Komunat	Numri i Bizneseve	Kërkesat sa i përket sipërfaqes së tokës së nevojshme
Prishtinë	15	49 hektarë
Dragash	2	9 hektarë
Ferizaj	8	22 hektarë e 80 ari
Fushë Kosovë	3	80 ari
Gjakovë	1	2 hektarë
Gjilan	6	11 hektarë
Kamenica	3	7 hektarë
Lipjan	1	40 ari
Malishevë	2	1 hektarë e 20 ari
Pejë	2	60 ari
Prizren	5	4 hektarë e 40 ari
Rahovec	1	60 ari
Viti	1	30 ari
Total	50	109 hektarë e 10 ari

Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Nga të dhënat e mbledhura, komunat me numrin më të madh të bizneseve që kërkojnë sipërfaqe të mëdha toke janë Prishtina dhe Ferizaj, me përkatësisht 15 biznese që kërkojnë 49 hektarë dhe 8 biznese që kërkojnë 22 hektarë e 80 ari. Në total, kërkesat për sipërfaqe toke arrijnë në 109 hektarë e 10 ari për 50 biznese në të gjithë komunat. Kjo tregon një nevojë të theksuar për tokë, veçanërisht në komunat më të zhvilluara, duke nënvizuar rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të hapësirave industriale për të përmbushur kërkesat e sektorëve të ndryshëm të biznesit.

Tabela 25. Vendet e punës të cilat do të krijohen

Sa vende pune do te krijoni nese vendosni në Parkun Industrial?	Numri i Bizneseve	Përqindja	Numri i përafërt i punëtorëve	Përqindja
11-20 punëtor	14	28%	172	23.34%
21-50 punëtor	12	24%	274	37.18%
Më pak se 10 punëtor	22	44%	84	11.40%
Më shumë se 101 punëtor	2	4%	207	28.09%
Total	50	100%	737	100%

Burimi: Të dhënat nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Nga të dhënat e mbledhura, nëse bizneset vendosen në një Park Industrial dhe Teknologjik, shumica prej tyre planifikojnë të krijojnë më pak se 10 vende pune ose (44%). 28% e bizneseve synojnë të krijojnë 11-20 vende pune, ndërsa 24% planifikojnë të krijojnë 21-50 vende pune. Vetëm 4% e bizneseve parashikojnë të krijojnë më shumë se 101 vende pune. Kjo tregon se parqet industriale mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm në krijimin e vendeve të punës, veçanërisht për bizneset e vogla dhe të mesme.

Numri i përafërt i punëtorëve është 737, ku 274 punëtorë ose 37.18% kontribuojnë nga bizneset me 21-50 punëtorë, dhe 207 punëtorë ose 28.09% vijnë nga bizneset me më shumë se 101 punëtorë. Ndërkohë, 172 punëtorë ose 23.34% janë nga bizneset me 11-20 punëtorë, ndërsa bizneset me më pak se 10 punëtorë kontribuojnë me 84 punëtorë ose 11.40% të totalit.

Bazuar në përgjigjet e mbledhura, investimet e planifikuara për Parqet Industriale dhe Teknologjike variojnë ndjeshëm, me shumicën e investitorëve që planifikojnë të investojnë mbi 1 milion Euro, disa deri në 3-5 milion Euro, dhe disa të tjerë që synojnë investime më modeste prej 200,000-euro deri në 500,000 Euro. Disa ende nuk kanë një vlerësim të qartë, ndërsa të tjerë shprehin gatishmërinë për të investuar por pa një shumë specifike të caktuar. Ky diversitet tregon një interes të madh dhe potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e këtyre parqeve, megjithatë, kërkohet një strukturë e mirëorganizuar për të mbështetur dhe kanalizuar këto investime në mënyrë efektive.

9. Identifikimi i rreziqeve të mundshme mjedisore

Kosova përballet me një sërë rreziqesh mjedisore që mund të ndikojnë negativisht në florën dhe faunën e saj të pasur dhe të larmishme. Një nga këto rreziqe është ndotja industriale, e cila mund të shkaktojë ndotje të ajrit, tokës dhe ujit, duke rrezikuar habitatet natyrore dhe duke ndikuar negativisht në shëndetin e ekosistemeve lokale. Dëmtimi i pyjeve për shkak të zgjerimit urban dhe bujqësisë intensive mund të shkaktojë humbjen e biodiversitetit, duke kërcënuar speciet endemike të florës dhe faunës. Shfrytëzimi i tepërt i burimeve natyrore, si gjuetia e pakontrolluar dhe mbledhja e bimëve të rralla, gjithashtu paraqet një rrezik për mbijetesën e specieve të rrezikuara. Ndryshimet klimatike mund të sjellin kushte më ekstreme të motit, si thatësira dhe përmbytje, të cilat mund të dëmtojnë më tej ekosistemet natyrore. Për të mbrojtur mjedisin dhe biodiversitetin, është thelbësore të zbatohen politika dhe praktika të qëndrueshme që mbrojnë florën dhe faunën e Kosovës nga këto rreziqe.

Ndërtimi i parqeve industriale dhe teknologjike nuk ndikon në ambient, pasi që veprimtaritë që zhvillohen në to duhet të jenë në harmoni me legjislacionin. Poashtu edhe fazat e ndërtimit nuk ndikojnë në ambient. E vetmja që mund të ndikojë në ambient mund të jetë ujërat industriale që dalin nga bizneset e vendosura në parqe, andaj edhe duhet të ndërtohen impiante për trajtimin e atyre ujërave.

Politikat për mbrojtjen e florës dhe faunës janë masa të ndërmarra nga shtetet dhe organizatat ndërkombëtare për të ruajtur dhe mbrojtur ekosistemet natyrore, llojet e rrezikuara dhe biodiversitetin.

Këto politika synojnë të parandalojnë degradimin e mjedisit dhe zhdukjen e llojeve, duke përfshirë ligje, rregullore dhe nisma të ndryshme. Disa nga aspektet kryesore të këtyre politikave janë:

1. Legjislacioni për mbrojtjen e specieve të rrezikuara, shumë vende kanë ligje që ndalojnë gjuetinë, peshkimin ose tregtinë e specieve të rrezikuara. Këto ligje shpesh përfshijnë ndëshkime për shkelje.
2. Krijimi i zonave të mbrojtura, rezervatet natyrore, parqet kombëtare dhe zonat e tjera të mbrojtura krijohen për të ruajtur habitatet natyrore dhe për të mbrojtur llojet e rrezikuara nga aktivitetet njerëzore.
3. Rregullimi i përdorimit të tokës dhe burimeve natyrore, politikat që kufizojnë shpyllëzimin, kullotjen e tepërt dhe ndotjen janë thelbësore për mbrojtjen e habitateve dhe për të parandaluar humbjen e biodiversitetit.
4. Nismat për restaurimin e ekosistemeve, projektet për rigjenerimin e pyjeve, lumenjve dhe ligatinave të degraduara janë një pjesë kyçe e politikave për mbrojtjen e florës dhe faunës.

5. Edukimi dhe ndërgjegjësimi publik, edukimi i komuniteteve dhe promovimi i praktikave të qëndrueshme janë thelbësore për suksesin afatgjatë të këtyre politikave.
6. Bashkëpunimi ndërkombëtar, marrëveshjet ndërkombëtare si Konventa për Diversitetin Biologjik dhe Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara (CITES) luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen globale të florës dhe faunës.

Këto politika janë kritike për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe sigurojnë që brezat e ardhshëm të trashëgojnë një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

10. Të identifikohet dhe të vlerësohet karakteristikat miqësore

Të identifikohen dhe të vlerësohen karakteristikat miqësore përfshin analizën dhe vlerësimin e aspekteve që ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe tërheqës për zhvillimin ekonomik. Këto karakteristika përfshijnë qëndrueshmërinë mjedisore duke respektuar standardet lokale dhe ndërkombëtare, promovimin e ekonomisë qarkore për të minimizuar mbetjet dhe maksimizuar përdorimin e burimeve, integrimin e teknologjive inovative dhe të gjelbra, dhe sigurimin e infrastrukturës moderne dhe mbështetëse. Gjithashtu, është e rëndësishme të vlerësohet ndikimi social dhe ekonomik i parqeve industriale dhe teknologjike, duke krijuar vende të reja pune, përmirësuar standardin e jetesës për komunitetet përreth, dhe promovuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve kërkimore, universiteteve dhe industrisë për të nxitur inovacionin dhe zhvillimin.

Karakteristikat miqësore dhe inovative që përfshijnë ekonominë qarkore përfshijnë disa aspekte kyçe janë:

1. Përfshirja e Komunitetit, zhvillimi i projekteve që përfshijnë komunitetin dhe krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme midis bizneseve dhe banorëve lokalë. Kjo ndihmon në krijimin e një ekonomie që punon për të gjithë.
2. Inovacioni dhe Teknologjia, përdorimi i teknologjive të reja për të përmirësuar efikasitetin e burimeve, ulur mbeturinat dhe krijuar produkte që mund të ripërdoren ose riciklohen. Kjo përfshin zhvillimin e materialeve të qëndrueshme dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme.
3. Zvogëlimi i Mbeturinave, një ekonomi qarkore synon të minimizojë mbetjet dhe të maksimizojë përdorimin e burimeve ekzistuese. Kjo mund të përfshijë dizajnimin e produkteve që kanë një jetëgjatësi të gjatë dhe janë lehtësisht të ripërdorshme ose të riciklueshme.
4. Efikasiteti i Burimeve, optimizimi i përdorimit të burimeve, duke reduktuar konsumin e lëndëve të para dhe duke përmirësuar përdorimin e energjisë dhe ujit.

5. Krijimi i Vlerës Sociale dhe Mjedisore, një ekonomi qarkore ka për qëllim të krijojë vlerë për shoqërinë dhe mjedisin, duke reduktuar ndotjen, përmirësuar cilësinë e jetës dhe mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.
6. Krijimi i Modeleve të Biznesit të Qëndrueshëm, ndërmarrjet që përqafojnë ekonomi qarkore shpesh zhvillojnë modele biznesi të reja që janë ekonomikisht të qëndrueshme dhe përfshijnë praktikën e riparimit, ripërdorimit dhe riciklimit si pjesë integrale të strategjisë së tyre.
7. Edukimi dhe Ndërgjegjësimi, edukimi i njerëzve dhe ndërgjegjësimi mbi përfitimet e ekonomisë qarkore, për të nxitur një kulturë të përgjegjshme ndaj mjedisit dhe burimeve. Këto karakteristika janë themelore për krijimin e një sistemi ekonomik që është i qëndrueshëm, etik dhe miqësor ndaj mjedisit, duke promovuar një të ardhme më të gjelbër dhe më të drejtë për të gjithë.

11. ANALIZA SWOT

Tabela 26. Analiza SWOT për komunat potenciale për krijimin e Parqeve Industriale dhe Teknologjike

Përparësitë	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Infrastrukturë në zgjerim: Shumë komuna kanë nisur investime për përmirësimin e infrastrukturës, me potencial për zgjerime të mëtejshme. • Vendndodhje atraktive për investime: Disa komuna gëzojnë pozicion strategjik që ofron qasje të lehtë në tregjet e brendshme dhe rajonale. • Politika në favor të zhvillimit: Komunat kanë mbështetjen e qeverisë lokale për të ndihmuar në zhvillimin e zonave të reja ekonomike. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesë kapacitetesh administrative lokale: Komunat kanë sfida në krijimin e strukturave administrative të përshtatshme për të menaxhuar parqe industriale dhe teknologjike. • Niveli i ulët i kualifikimit të punëtorëve lokalë: Komunat e largëta mund të kenë nevojë për më shumë investime në edukim dhe trajnime për fuqinë punëtore.
Mundësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> • Potencial i lartë për projekte të reja: Komunat mund të fokusohen në zhvillimin e sektorëve të rinj si teknologjia, bujqësia ose turizmi, duke shfrytëzuar resurset natyrore dhe avantazhet konkurruese. • Zhvillimi i Sektorëve të Rinj: Ekziston mundësia për të zhvilluar sektorë të rinj të ekonomisë, si teknologjia e informacionit dhe komunikacionit (TIK), që mund të kontribuojnë në diversifikimin ekonomik. • Përmirësimi i Teknologjisë dhe Infrastrukturës: Me investime të reja, ekziston potenciali për të përmirësuar teknologjinë dhe infrastrukturën, duke rritur kështu atraktivitetin e komunave. 	<ul style="list-style-type: none"> • Politika të paqëndrueshme: Vendimet e papritura të qeverisë ose mungesa e përkrahjes së qëndrueshme për komunat mund të pengojnë zhvillimin e zonave. • Përballje me konkurrencën nga rajoni: Komunat do të duhet të ofrojnë kushte të favorshme për të konkurruar me ofertat e tjera rajonale

12. Konkluzione

Bazuar në analizën e të dhënave nga pyetëtori dhe ligjin për parqe industriale dhe teknologjike, mund të konkludohet se zonat ekonomike në Kosovë kanë infrastrukturë të zhvilluar dhe pozicion strategjik që i bën ato tërheqëse për investitorët, mbështetur nga përkrahja qeveritare. Administrimi i parqeve kryhet kryesisht nga komunat përkatëse, me përjashtim të parkut industrial në Drenas, i cili administrohet nga MINT dhe komuna e Drenasit. Megjithatë, procedurat komplekse administrative përbëjnë sfida të mëdha, së bashku me mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe infrastrukturës së pamjaftueshme në disa zona. Potenciali për investime të huaja direkte dhe zhvillimi i sektorëve të rinj janë mundësi të rëndësishme që mund të shfrytëzohen për të përmirësuar teknologjinë dhe infrastrukturën, duke adresuar dobësitë dhe rritur atraktivitetin e zonave ekonomike. Ndryshimet e papritura në politikat qeveritare, konkurrenca nga vendet fqinje dhe rritja e kostove të energjisë dhe lëndëve të para mbeten kërcënime të mundshme që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme.

13. Rekomandime

Për të përmirësuar funksionimin dhe atraktivitetin e parqeve industriale dhe teknologjike në Kosovë, rekomandohet thjeshtësimi i procedurave administrative për të tërhequr më shumë investitorë, investimi në arsim dhe trajnime profesionale për të rritur kapacitetet e fuqisë punëtore të kualifikuar, përmirësimi i infrastrukturës në zonat ku mungon, nxitja e investimeve të huaja direkte përmes incentivave (ofrimin e pronave me procedurë të lehtësuar, identifikimi i fuqisë punëtore, lidhshmëria me bizneset vendore, lehtësira në procedura administrative për të bërë biznes, etj) dhe promovimit aktiv, sigurimi i një kuadri ligjor dhe politik stabil për të rritur besimin e investitorëve, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet qeverisë qendrore dhe komunave për administrimin efektiv, dhe inkurajimi i zhvillimit të sektorëve të rinj, si teknologjia e informacionit dhe komunikacionit, për të diversifikuar ekonominë dhe krijuar mundësi të reja për rritje ekonomike.

Kapitulli III

Legjislacioni i zonave ekonomike në Kosovë

1. Analizimi i legjislacionit të parqeve industriale dhe teknologjike vendore dhe ndërkombëtare

Ligji nr.08/1-208 për parqet industriale dhe teknologjike, ka për qëllim të rregullojë themelimin, administrimin, menaxhimin, promovimin, shfrytëzimin dhe monitorimin e parqeve industriale dhe parqeve teknologjike, duke përfshirë inkubatorët e biznesit në Republikën e Kosovës.

Objektivat e parkut industrial dhe teknologjik janë ofrimi i infrastrukturës së përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike dhe ka për qëllim të mbështes investimet e përgjegjshme dhe të qëndrueshme, të nxitë veprimtaritë prodhuese dhe përpunuese, inovacionin, punësimin, aftësimin, nxitjen dhe zhvillimin e ekosistemit inovativ dhe bashkëpunimit mes shoqërive tregtare, rritjen e konkurrueshmërisë, mbështetjen e eksportit, etj.

Bazuar në ligjin në fjalë kemi këto lloje të parqeve:

- Park i përgjithshëm - park me ose pa ndërtesa industriale të ndërtuara paraprakisht, i destinuar përgjithësisht për veprimtari ekonomike;
- Park i specializuar - park me ose pa ndërtesa industriale të ndërtuara paraprakisht, i destinuar për industritë specifike dhe veprimtarive të ndërlidhura;
- Park për inovacion dhe teknologji - park i destinuar për veprimtari që lidhen me inovacionin, institucionet e arsimit të lartë dhe arsimit e aftësimin profesional, teknologjinë e avancuar dhe zhvillimin e prototipeve në funksion të veprimtarive ekonomike.

Themelimi i Parqeve industriale dhe teknologjike bëhet me vendim të Qeverisë pas rekomandimit të Ministrisë.

Themelimin e parkut industrial dhe teknologjik mund ta propozojë:

- Ministria;
- AIE – Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve;
- komuna;
- shoqëritë tregtare vendore dhe ndërkombëtare të regjistruara në Republikën e Kosovës; ose
- asociacionet e biznesit vendore dhe ndërkombëtare të regjistruara në Republikën e Kosovës.

Parqet industriale dhe teknologjike mund të themelohen, ndërtohen dhe administrohen përmes partneritetit publiko privat në pajtim me ligjin përkatës.

Menaxhimi i parkut industrial dhe teknologjik mund të bëhet nga: autoriteti publik, shoqëri tregtare, organizatë joqeveritare, partneritet publiko-privat. Menaxhuesin e përzgjedh administruesi i parkut industrial përmes thirrjes së hapur ose sipas kërkesës. Përzgjedhja bëhet në mënyrë transparente.

Monitorimi bëhet nga trupa monitoruese të themeluar nga Ministria për parqet industriale dhe teknologjike, përfshirë edhe inkubatorët e biznesit. Trupat monitorojnë zbatimin e politikave në parkun industrial dhe teknologjik ose inkubatorin e biznesit.

2. Krahasim i legjislacionit të zonave ekonomike midis Kosovës dhe Shqipërisë

Legjislacioni që rregullon zonat ekonomike, parqet industriale dhe teknologjike në Kosovë është i detajuar dhe synon të promovojë zhvillimin ekonomik përmes mbështetjes së investimeve, nxitjes së inovacionit dhe krijimit të vendeve të punës. Për të bërë një krahasim, mund të shqyrtojmë legjislacionin për zonat ekonomike në një vend tjetër, si për shembull në Shqipëri, që gjithashtu ka një legjislacion të ngjashëm, por me disa dallime thelbësore.

LEGJISLACIONI I ZONAVE EKONOMIKE NË SHQIPËRI

Në Shqipëri, ligji kryesor që rregullon zonat ekonomike është **Ligji Nr. 9789, datë 19.07.2007**, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”. Ky ligj përfshin krijimin, funksionimin dhe menaxhimin e zonave të lira ekonomike, të cilat janë zona të përcaktuara ku investitorët përfitojnë nga një sërë lehtësimesh fiskale dhe administrative.

Krahasim i Përgjithshëm

Qëllimi dhe Fushëveprimi

Kosova: Ligji për parqet industriale dhe teknologjike synon rregullimin e themelimit, administrimit, menaxhimit, promovimit, shfrytëzimit dhe monitorimit të këtyre parqeve, duke përfshirë inkubatorët e biznesit.

Shqipëria: Ligji për zonat ekonomike synon krijimin dhe funksionimin e zonave të lira ekonomike për të promovuar zhvillimin ekonomik, tërheqjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës.

Llojet e Zonave

- **Kosova:** Parqet mund të jenë të përgjithshme, të specializuara ose për inovacion dhe teknologji.
- **Shqipëria:** Zonat mund të jenë të përgjithshme ose të specializuara në varësi të llojit të aktiviteteve ekonomike të kryera në to.

Themelimi

- **Kosova:** Parqet themelohen me vendim të Qeverisë pas rekomandimit të Ministrisë dhe mund të propozohet nga ministria, agjencia e investimeve dhe eksporteve, komuna, shoqëritë tregtare, apo asociacionet e biznesit.

- **Shqipëria:** Zonat krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave pas propozimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe financave, dhe mund të propozohet nga autoritetet qendrore ose lokale, si dhe nga investitorët privatë.

Menaxhimi

- **Kosova:** Menaxhimi mund të kryhet nga autoritetet publike, shoqëritë tregtare, organizatat joqeveritare, ose përmes partneritetit publiko-privat.
- **Shqipëria:** Menaxhimi i zonave të lira ekonomike mund të bëhet nga shoqëritë private të menaxhimit ose nga autoritetet publike, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.

Ngjashmëritë:

Të dy vendet kanë legjislacion të detajuar që synon të promovojë investimet dhe të zhvillojë sektorin ekonomik përmes krijimit të zonave të veçanta.

Të dy ligjet mbështesin krijimin e infrastrukturës dhe ofrimin e lehtësirave për tërheqjen e investimeve.

Dallimet:

Struktura e Propozimeve dhe Themelimit: Në Kosovë, procesi është më i detajuar në lidhje me përfshirjen e shumë institucioneve dhe kriteret për themelimin e parqeve.

Lehtësirat Fiskale: Shqipëria ka një fokus më të madh në specifikimin e lehtësirave fiskale dhe administrative që ofrohen për investitorët në zonat ekonomike.

Monitorimi dhe Menaxhimi: Kosova ka një strukturë më të qartë dhe të detajuar për monitorimin e parqeve, përfshirë krijimin e trupave monitoruese dhe raportimin e aktiviteteve të parqeve.

Përfundim

Ligjet e Kosovës dhe Shqipërisë për zonat ekonomike kanë shumë ngjashmëri në synimet e tyre për promovimin e zhvillimit ekonomik dhe tërheqjen e investimeve. Megjithatë, detajet specifike të zbatimit, menaxhimit dhe incentivat fiskale tregojnë një qasje të ndryshme, me Kosovën që ka një strukturë më të detajuar dhe Shqipërinë që thekson më shumë lehtësirat fiskale dhe administrative për investitorët.

3. Krahasim i Legjislacionit të Zonave Ekonomike midis Kosovës dhe Italisë

Legjislacioni që rregullon zonat ekonomike, parqet industriale dhe teknologjike në Kosovë është i detajuar dhe synon të promovojë zhvillimin ekonomik përmes mbështetjes së investimeve, nxitjes së inovacionit dhe krijimit të vendeve të punës. Për të bërë një krahasim, mund të shqyrtojmë legjislacionin për zonat ekonomike në një vend tjetër, si për shembull në Itali, që gjithashtu ka një legjislacion të ngjashëm, por me disa dallime thelbësore.

LEGJISLACIONI I ZONAVE EKONOMIKE NË ITALI

Në Itali, ligji kryesor që rregullon zonat ekonomike është Ligji Nr. 91, datë 21.06.2017, i cili krijon dhe rregullon zonat ekonomike të veçanta (Zone Economiche Speciali - ZES). Ky ligj përfshin krijimin, funksionimin dhe menaxhimin e këtyre zonave të veçanta për të tërhequr investime dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik, veçanërisht në rajonet më pak të zhvilluara.

Qëllimi dhe Fushëveprimi

- **Kosova:** Ligji për parqet industriale dhe teknologjike synon rregullimin e themelimit, administrimit, menaxhimit, promovimit, shfrytëzimit dhe monitorimit të këtyre parqeve, duke përfshirë inkubatorët e biznesit.
- **Italia:** Ligji për zonat ekonomike të veçanta synon krijimin dhe funksionimin e këtyre zonave për të promovuar zhvillimin ekonomik, tërheqjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës, veçanërisht në rajonet jugore të vendit.

Llojet e Zonave

Kosova: Parqet mund të jenë të përgjithshme, të specializuara ose për inovacion dhe teknologji.

- **Italia:** Zonat ekonomike të veçanta janë të përcaktuara kryesisht në rajonet jugore të Italisë dhe janë të orientuara drejt zhvillimit ekonomik dhe tërheqjes së investimeve.

Themelimi

Kosova: Parqet themelohen me vendim të Qeverisë pas rekomandimit të Ministrisë dhe mund të propozohet nga Ministria, Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve, komuna, shoqëritë tregtare, apo asociacionet e biznesit.

- **Italia:** Zonat ekonomike të veçanta krijohen me dekret të Presidentit të Republikës pas propozimit të Ministrit të Kohezionit Territorial dhe Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, dhe mund të propozohet nga autoritetet qendrore ose rajonale.

Menaxhimi

- **Kosova:** Menaxhimi mund të kryhet nga autoritetet publike, shoqëritë tregtare, organizatat joqeveritare, ose përmes partneritetit publiko-privat.
- **Italia:** Menaxhimi i zonave ekonomike të veçanta bëhet nga një Komitet Menaxhues, i cili përfshin përfaqësues nga qeveria qendrore, rajonale dhe lokale, si dhe nga sektori privat.

Ngjashmëritë:

- Të dy vendet kanë legjislacion të detajuar që synon të promovojë investimet dhe të zhvillojë sektorin ekonomik përmes krijimit të zonave të veçanta.
- Të dy ligjet mbështesin krijimin e infrastrukturës dhe ofrimin e lehtësirave për tërheqjen e investimeve.

Dallimet:

- **Struktura e Propozimeve dhe Themelimit:** Në Kosovë, procesi është më i detajuar në lidhje me përfshirjen e shumë institucioneve dhe kriteret për themelimin e parqeve. Në Itali, theksi është më shumë në koordinimin ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe sektorit privat.
- **Lehtësirat Fiskale:** Italia ka një fokus më të madh në specifikimin e lehtësirave fiskale dhe administrative që ofrohen për investitorët në zonat ekonomike të veçanta.
- **Monitorimi dhe Menaxhimi:** Kosova ka një strukturë më të qartë dhe të detajuar për monitorimin e parqeve, përfshirë krijimin e trupave monitoruese dhe raportimin e aktiviteteve të parqeve. Italia përdor një Komitet Menaxhues për menaxhimin dhe monitorimin e zonave.

Përfundim

Ligjet e Kosovës dhe Italisë për zonat ekonomike kanë shumë ngjashmëri në synimet e tyre për promovimin e zhvillimit ekonomik dhe tërheqjen e investimeve. Megjithatë, detajet specifike të zbatimit, menaxhimit dhe incentivat fiskale tregojnë një qasje të ndryshme, me Kosovën që ka një strukturë më të detajuar dhe Italinë që thekson më shumë lehtësirat fiskale dhe administrative për investitorët.

4. Krahasim i legjislacionit të zonave ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë

LEGJISLACIONI I ZONAVE EKONOMIKE NË SLLOVENI

Në Slloveni, legjislacioni që rregullon zonat ekonomike është i bazuar në Ligjin për Zonat e Veçanta Ekonomike (Zakona o posebnih gospodarskih območjih - ZPGO), i cili krijon dhe rregullon funksionimin e këtyre zonave për të tërhequr investime dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik, veçanërisht në rajonet më pak të zhvilluara.

- **Kosova:** Ligji për parqet industriale dhe teknologjike synon rregullimin e themelimit, administrimit, menaxhimit, promovimit, shfrytëzimit dhe monitorimit të këtyre parqeve, duke përfshirë inkubatorët e biznesit.
- **Sllovenia:** Ligji për zonat e veçanta ekonomike synon krijimin dhe funksionimin e këtyre zonave për të promovuar zhvillimin ekonomik, tërheqjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës në rajonet më pak të zhvilluara të vendit.

Llojet e zonave

- **Kosova:** Parqet mund të jenë të përgjithshme, të specializuara ose për inovacion dhe teknologji.
- **Sllovenia:** Zonat ekonomike të veçanta janë të fokusuar në zhvillimin ekonomik të rajoneve specifike, me një orientim të veçantë drejt inovacionit dhe teknologjisë.

Themelimi

- **Kosova:** Parqet themelohen me vendim të Qeverisë pas rekomandimit të Ministrisë dhe mund të propozohet nga ministria, agjencia e investimeve dhe eksporteve, komuna, shoqëritë tregtare, apo asociacionet e biznesit.
- **Sllovenia:** Zonat ekonomike të veçanta krijohen me vendim të Qeverisë, bazuar në propozimet e ministrisë përkatëse dhe autoriteteve rajonale.

Menaxhimi

- **Kosova:** Menaxhimi mund të kryhet nga autoritetet publike, shoqëritë tregtare, organizatat joqeveritare, ose përmes partneritetit publiko-privat.
- **Sllovenia:** Menaxhimi i zonave ekonomike të veçanta bëhet nga një Komitet Menaxhues, i cili përfshin përfaqësues nga qeveria qendrore, rajonale dhe lokale, si dhe nga sektori privat.

Ngjashmëritë:

- Të dy vendet kanë legjislacion të detajuar që synon të promovojë investimet dhe të zhvillojë sektorin ekonomik përmes krijimit të zonave të veçanta.
- Të dy ligjet mbështesin krijimin e infrastrukturës dhe ofrimin e lehtësirave për tërheqjen e investimeve.

Dallimet:

- **Struktura e Propozimeve dhe Themelimit:** Në Kosovë, procesi është më i detajuar në lidhje me përfshirjen e shumë institucioneve dhe kriteret për themelimin e parqeve. Në Slloveni, theksi është më shumë në koordinimin ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe sektorit privat.
- **Lehtësirat Fiskale:** Sllovenia ka një fokus më të madh në specifikimin e lehtësirave fiskale dhe administrative që ofrohen për investitorët në zonat ekonomike të veçanta.
- **Monitorimi dhe Menaxhimi:** Kosova ka një strukturë më të qartë dhe të detajuar për monitorimin e parqeve, përfshirë krijimin e trupave monitoruese dhe raportimin e aktiviteteve të parqeve. Sllovenia përdor një Komitet Menaxhues për menaxhimin dhe monitorimin e zonave.

Përfundim

Ligjet e Kosovës dhe Sllovenisë për zonat ekonomike kanë shumë ngjashmëri në synimet e tyre për promovimin e zhvillimit ekonomik dhe tërheqjen e investimeve. Megjithatë, detajet specifike të zbatimit, menaxhimit dhe incentivat fiskale tregojnë një qasje të ndryshme, me Kosovën që ka një strukturë më të detajuar dhe Slloveninë që thekson më shumë lehtësirat fiskale dhe administrative për investitorët.

5. Legjislacioni i zonave ekonomike në Maqedoninë e Veriut

Në Maqedoninë e Veriut, ligji kryesor që rregullon zonat ekonomike është Ligji për Zonat Teknologjike Industriale Zhvillimore (ZTIZ), i cili synon krijimin e kushteve të favorshme për investimet e huaja dhe vendore, për të promovuar zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe për të përmirësuar eksportet.

Krahasim i Përgjithshëm

- **Kosova:** Ligji për parqet industriale dhe teknologjike synon rregullimin e themelimit, administrimit, menaxhimit, promovimit, shfrytëzimit dhe monitorimit të këtyre parqeve, duke përfshirë inkubatorët e biznesit.

- **Maqedonia e Veriut:** Ligji për ZTIZ synon krijimin e zonave teknologjike-industriale me qëllim të tërheqjes së investimeve, nxitjen e zhvillimit teknologjik, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e eksportit.

Llojet e Zonave

- **Kosova:** Parqet mund të jenë të përgjithshme, të specializuara ose për inovacion dhe teknologji.
- **Maqedonia e Veriut:** Zonat janë kryesisht teknologjike-industriale dhe fokusohet në zhvillimin e teknologjisë dhe industrisë për eksport.

Themelimi

- **Kosova:** Parqet themelohen me vendim të Qeverisë pas rekomandimit të Ministrisë dhe mund të propozohet nga ministria, agjencia e investimeve dhe eksporteve, komuna, shoqëritë tregtare, apo asociacionet e biznesit.
- **Maqedonia e Veriut:** Zonat teknologjike-industriale krijohen me vendim të Qeverisë dhe propozimi mund të bëhet nga ministria përkatëse, agjencitë shtetërore, apo nga investitorët privatë.

Menaxhimi

- **Kosova:** Menaxhimi mund të kryhet nga autoritetet publike, shoqëritë tregtare, organizatat joqeveritare, ose përmes partneritetit publiko-privat.
- **Maqedonia e Veriut:** Zonat menaxhohen kryesisht nga autoritetet publike ose përmes partneriteteve me sektorin privat, me një fokus të veçantë në përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për investitorët.

Ngjashmëritë:

- Të dy vendet kanë legjislacion që synon promovimin e investimeve dhe zhvillimin ekonomik përmes krijimit të zonave të veçanta teknologjike-industriale.
- Të dy ligjet mbështesin krijimin e infrastrukturës dhe ofrimin e lehtësirave për tërheqjen e investimeve, duke siguruar mbështetje për investitorët.

Dallimet:

- **Fokusi i Zonave:** Maqedonia e Veriut ka një fokus të qartë në teknologjinë dhe industrinë për eksport, ndërsa Kosova ofron një gamë më të gjerë opsionesh për llojet e parqeve, përfshirë inovacionin dhe teknologjinë.

- **Struktura e Themelimit:** Procesi i themelimit në Kosovë është më i përfshirë, me përfshirjen e shumë institucioneve në vendimmarrje, ndërsa në Maqedoninë e Veriut, procesi është më i drejtpërdrejtë dhe i orientuar nga investitorët.
- **Lehtësirat dhe Incentivat:** Maqedonia e Veriut ofron një sërë lehtësirash specifike për investitorët në zonat teknologjike-industriale, të cilat janë më të orientuara drejt nxitjes së zhvillimit teknologjik dhe përmirësimit të eksportit.

Përfundim

Ligjet e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për zonat ekonomike kanë synime të ngjashme për tërheqjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik. Megjithatë, dallimet në qasjet e tyre pasqyrojnë prioritetet specifike të secilit vend, me Kosovën që ofron një strukturë më të gjerë dhe të detajuar, ndërsa Maqedonia e Veriut është më e fokusuar në teknologjinë dhe industrinë për eksport.

6. Palët kryesore të interesit

Palët kryesore të interesit në zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë përfshijnë qeverinë e Kosovës (MINT dhe KIESA) për politikëbërjen dhe mbështetjen e investimeve, investitorët e huaj dhe vendorë që kërkojnë të shfrytëzojnë avantazhet konkurruese, bashkitë dhe komunat lokale për implementimin e projekteve ekonomike, institucionet financiare për sigurimin e fondeve, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët për mbështetje teknike dhe financiare, komunitetin e biznesit dhe shoqatat e tregtisë për përfaqësimin e interesave të sektorit privat, universitetet dhe institucionet kërkimore për zhvillimin e aftësive dhe inovacionit, si dhe OJQ-të dhe komunitetin civil për çështjet mjedisore dhe sociale. Këto palë bashkëpunojnë për të siguruar një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

7. Konkluzione

Ligji për parqe industriale dhe teknologjike ofron një bazë ligjore të rëndësishme për zhvillimin dhe operimin e parqeve industriale dhe teknologjike të destinuara për tërheqjen e investimeve dhe rritjen e aktivitetit ekonomik. Përparësitë fiskale dhe administrative që ofrohen në këto zona janë tërheqëse për investitorët vendas dhe ndërkombëtarë, duke kontribuar në rritjen e sektorit privat dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

8. Rekomandime

1. **Rishikim dhe përmirësim i kushteve ligjore:** Nënvizojnë nevojën për një rishikim periodik të ligjit për zonat ekonomike për të siguruar që kushtet dhe insentivat e ofruara janë konkurruese në nivel rajonal dhe global.
2. **Fokus më i madh në infrastrukturë:** Investimi në infrastrukturë, si rrugët, energjia dhe komunikimet, do të ndihmonte në rritjen e atraktivitetit të zonave ekonomike për investitorët dhe do të ndihmonte në integrimin më të mirë të këtyre zonave në ekonominë vendase.
3. **Promovimi dhe marketingu i parqeve industriale dhe teknologjike:** Nevojitet një strategji e qartë dhe efektive e promovimit dhe marketingut për të rritur ndërgjegjësimin dhe interesin e investitorëve potencialë në zonat ekonomike të Kosovës.
4. **Përmirësimi i bashkëpunimit publik-privat:** Për të garantuar një qasje të koordinuar dhe efektive në menaxhimin e zonave ekonomike, është e rëndësishme thellimi i bashkëpunimit mes sektorit publik dhe privat.

Këto rekomandime synojnë të përmirësojnë kushtet dhe të rrisin suksesin e parqeve industriale dhe teknologjike në Kosovë në të ardhmen.

9. Aneks 1. Vendimet e themelimit të zonave ekonomike

Parku i biznesit në Drenas – Vendim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/8E2AE57B-1DC7-4466-9DFC-35541BDD6704.pdf>

Parku i biznesit në Mitrovicë – Vendim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/2B50B634-CF68-4C2B-B8C9-6659B9837AB6.pdf>

Parku Teknologjik në Shtime - Pëlqim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/753667A3-B814-4A91-9D2C-8989FDBA13FA.pdf>

Parku Industrial në Mitrovicë - Pëlqim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/245369B3-BF97-469A-9EFB-C46537BE0CE7.pdf>

Zona Agro Industriale në Samadraxhë - Suaherekë - Vendim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/B818C558-FC0A-4247-866C-BE1796633C63.pdf>

Parku Industrial në Lipjan - Vendim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/A7AD7B4A-841E-4172-8DA3-E8C7BBAF831B.pdf>

Parku Industrial Shirokë - Vendim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/7A773E89-5E44-4C7C-9D41-157737E8C7D5.pdf>

Parkut Industrial në Viti - Vendim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/57D6D976-34A5-4E0D-BA3D-1509510B405E.pdf>

Parku Industrial në Vushtrri - Vendim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/E0FE95E6-25AB-4E55-8494-09EA7A52DB40.pdf>

Zona Ekonomike në Opterushë - Vendim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/49878E8D-3100-4AAE-A6D0-484E6FD822BE.pdf>

Parku i Përgjithshëm në Komunën e Podujevës - Vendim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/F4318FBE-B9CF-46EA-B332-FC340E61BF7C.pdf>

Parku i Përgjithshëm në Komunën e Drenasit - Vendim

<https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/7BC1511D-2A42-48DF-8AFE-0C4062877B19.pdf>